



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 21, datë 21.01.2025

PËR

**VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT {...} PËR PERIUdhËN
2017 - 2019**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 85, 89 dhe 95, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, i hartuar nga relatores znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017- 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A Njohuritë ligjore.

1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave.

Roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “*Gjykata e njeh ligjin*”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, natyrën juridike të saj dhe referencën relevante që gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përcaktimin e fakteve të çështjes, gjyqtari referuar objektit të mosmarrëveshjes apo natyrës së çështjes (gjykim penal themeli, kërkesë e seancës paraprake ose kërkesë penale gjatë fazës së ekzekutimit apo hetimit) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar), i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar dhe analizës së fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato në pjesën e parë në nënpjesën “Procedura”¹ dhe të dytë “Rrethanat e çështjes” apo “Rrethat e çështjes dhe burimi i provave” të arsytimit të vendimit.

¹ Kjo nënpjesë pjesë kryesisht mungon, por gjendet në disa vendime

Paraqitja e rrethanave procedurale, thuajse në të gjitha vendimet penale, përshkruhen dhe po ashtu analizohen në një nënndarje që përbën pjesën hyrëse të arsyetimit, të titulluar “procedura”, në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore², përbërjen e trupit gjykues, aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes lidhur me paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, për procedim me gjykim të shkurtuar, mundësisë së ndarjes së çështjes, riçeljen e hetimit gjyqësor etj.

Në këto vendime gjyqësore ku rrethana procedurale që lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve apo çështjeve të ngritura kryesisht për vlerësim nga gjykata, përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqërohet me vlerësimin dhe analizën ligjore lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, duke i dhënë qartësi vendimit dhe duke orientuar lidhur me elementë të tillë si: ndërgjyqësia, procedura e gjykimit (*gjykim i shkurtuar ose jo*), zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, pjesëmarrjen dhe përfaqësimin e tyre në gjykim, legjitimitetin aktiv të kërkuesit etj.

Menjëherë pas paraqitjes dhe vlerësimit në lidhje me rrethanat me karakter procedural, gjyqtari parashtron faktet e çështjes objekt gjykimi, që në të shumtën e rasteve, ndodhen të përshkruara bashkë, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e faktit” si në çështjet penale themeli, ashtu edhe në seancat paraprake apo kërkesat penale, duke i parashtruar ato përgjithësisht në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, dhe duke integruar në përmbajtje të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Faktet e çështjes janë përshkruar dhe analizuar në mënyrë koncize apo të detajuar (në varësi të kompleksitetit të çështjes), duke u shoqëruar me evidentimin dhe pasqyrimin e provave.

Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtari identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, natyra e çështjes përcaktohet që në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, referuar specifikave të saj. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike objekt shqyrtimi i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarit, duke u bërë në mënyrë të shprehur, apo duke iu referuar akuzave që iu atribuohen të pandehurve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të saj.

Sa i përket ligjit procedural:

Referuar natyrës së çështjes (*çështje penale e fazës së hetimit, seancës paraprake, gjykim themeli apo kërkesë në fazën e ekzekutimit*), apo rritit të gjykimit (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar*), gjyqtari identifikon dispozitat procedurale, si më poshtë:

² Merret në shqyrtim kryesisht në vendimet e kategorisë “seancë paraprake”

- nenin 4 të K. Pr. Penale në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë³,
- nenin 13 të K. Pr. Penale në lidhje me përbërjen e trupin gjykues që shqyrton kërkesën⁴ ;
- nenet 69, 74 dhe 477 të K. Pr. Penale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës⁵;
- nenin 82 të K. Pr. Penale në lidhje me kompetençën tokësore nga lidhja e procedimeve⁶,
- nenin 152 të K. Pr. Penale në lidhje me çmuarjen e provave⁷;
- nenin 190 të K. Pr. Penale në lidhje me disponimin për provat materiale⁸,
- nenin 234 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit *“Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”*⁹,
- nenin 237, 238 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit *“Arrest në shtëpi”* dhe *“Arrest në burg”*¹⁰,
- nenin 261 dhe 262 të K. Pr. Penale në lidhje me rrethanat e shuarjes së masës së sigurimit dhe pasojat¹¹,
- nenin 354 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesat paraprake¹² ;
- nenin 375 të K. Pr. Penale në lidhje me ndryshimin e cilësimit juridik¹³;
- nenin 389 të K. Pr. Penale në lidhje me disponimin mbi masat e sigurimit¹⁴,
- nenin 290 të K. Pr. Penale në lidhje me rrethanat që nuk lejojnë fillimin e procedimit penal¹⁵,
- nenin 387 të K. Pr. Penale në lidhje me pushimin e çështjes¹⁶,
- nenin 388 të K. Pr. Penale në lidhje me vendimin e pafajësisë¹⁷;
- nenin 391 të K. Pr. Penale në lidhje me deklarimin për falsitetin e dokumenteve¹⁸
- nenin 428 dhe 442 të K. Pr. Penale në lidhje me disponimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës së Lartë kur janë rastet që ndjekja penale nuk duhet të fillonte/vazhonte¹⁹;
- nenin 403 dhe 404 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për gjykim të shkurtuar dhe nenin 406 të K. Pr. Penale në lidhje me uljen e dënimit për shkak të aplikimit të gjykimit të shkurtuar²⁰,

³ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

⁴ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

⁵ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

⁶ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

⁷ Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018

⁸ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

⁹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017

¹⁰ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018

¹¹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018

¹² Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

¹³ Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

¹⁴ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

¹⁵ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

¹⁶ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

¹⁷ Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

¹⁸ Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

¹⁹ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

- nenin 393 dhe 485 të K. Pr. Penale në lidhje me shpenzimet procedurale²¹.

Sa i përket ligjit material të zbatueshëm, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtari identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, i cili gjen zbatim në zgjidhjen e çështjes objekt shqyrtimi. Në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, konstatohet se gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në pjesën e posaçme të Kodit Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit, si edhe dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal.

Identifikon, në funksion të cilësimit juridik të faktit penal dhe analizës së elementëve të figurës së veprës penale :

- nenin 1, 1/b dhe 1/c të K. Penal në lidhje me ndarjen e veprave penale, me objektin e legjislacionit penal dhe parimet në të cilat mbështetet K. Penal si dhe nenin 2 të K. Penal në lidhje me mosdënimin pa ligj²²;
- nenin 3 të K. Penal në lidhje me veprimin e ligjit penal në kohë dhe fuqinë prapavepruese²³,
- nenin 12 dhe 17 të K. Penal në lidhje me subjektin e veprës penale dhe përgjegjshmërinë e tij²⁴,
- nenin 14 të K. Penal në lidhje me fajin²⁵ ;
- nenin 25 të K. Penal në lidhje me bashkëpunimin ²⁶;
- nenin 47 të K. Penal në lidhje me caktimin e dënimit²⁷,
- nenet 48-50 të K. Penal në lidhje me rrethanat lehtësuese dhe rënduese²⁸,

²⁰ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

²¹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

²² Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

²³ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

²⁴ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

²⁵ Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

²⁶ Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

²⁷ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

²⁸ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

- nenin 55 të K. Penal në lidhje me bashkimin e dënimeve²⁹,
- nenin 57 të K. Penal në lidhje me llogaritjen e paraburgimit³⁰;
- nenet 58-65 të K. Penal në lidhje me alternativat e dënimit me burgim³¹,
- nenin 59 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe vënien në provë³²;
- nenin 62 të K. Penal në lidhje me shkeljen e kushteve dhe detyrimeve gjatë kohës së provës³³;
- nenin 63 të K. Penal në lidhje me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim dhe kryerjen e një pune në interes publik³⁴;
- nenin 64 të K. Penal në lidhje me lirimimin me kusht³⁵;
- nenin 71 të K. Penal në lidhje me amnistinë³⁶;
- nenin 84 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kanosja”³⁷;
- nenin 274 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Prishje e qetësisë publike”³⁸;
- nenin 277 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vetgjyqësia”³⁹;
- nenin 278/5 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake” (duke pasqyruar ndryshimet sipas ligjeve 144/2013, 98/2014, 135/2015 dhe 82/2016)⁴⁰;
- nenin 130/a/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Dhuna në familje”⁴¹;
- nenin 137/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike”⁴²;
- nenin 189 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave” dhe nenin 297 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Kalimi i paligjshëm i kufirit shtetëror”⁴³;
- nenin 278/3 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”⁴⁴;
- nenin 283 të K. Penal në lidhje me veprën penale “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”⁴⁵.

²⁹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

³⁰ Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018

³¹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

³² Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

³³ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

³⁴ Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018

³⁵ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

³⁶ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

³⁷ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

³⁸ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

³⁹ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

⁴⁰ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

⁴¹ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

⁴² Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017

⁴³ Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

⁴⁴ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018

⁴⁵ Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

Në çështjet penale me objekt *“Pushim i procedimit penal”*, *‘Dërgim i çështjes në gjyq’* apo *“Kundërshtim vendim pushimi”* identifikon dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të ekzistencës ose jo të faktit penal për të cilën kërkohet pushimi i procedimit penal për të konkluduar për pranimin e kërkesës për pushimin e çështjes:

- nenet nenin 186 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i dokumentave”*, nenin 187 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i dokumentave shkollore”*, nenin 188 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i dokumentave shëndetësore”*, nenin 189 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave ose vizave”*, nenin 190 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i vulave, stampave ose formularëve”*, si dhe nenin 191 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i akteve të gjendjes civile”*⁴⁶; nenin 140 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Vjedhja me arme”*⁴⁷; nenin 137/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”*⁴⁸; nenin 151 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Shkatërrimi i pronës me zjarr”*, si dhe nenin 161 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”*⁴⁹; nenin 134/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Vjedhja”*⁵⁰;
- nenin 139 dhe 25 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Vjedhja me dhunë”* e kryer në bashkëpunim, nenin 84 e 25 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Kanosja”* në bashkëpunim, si dhe nenin 242 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Mosbindja ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik”*⁵¹; nenin 113 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Prostitucioni”*, nenin 114/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Shfrytëzim i prostitucionit”*, nenin 115 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Mbajtja e lokaleve për prostitucion”*, nenin 137/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike”*, nenin 170/ç të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Ushtrimi pa{...}ncë i veprimtarisë financiare”*, nenin 199/a/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Ndërtim i paligjshëm”*, si dhe nenin 287/1 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”*⁵²; nenin 291 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Drejtimi i automjetit në mënyrë të parregullt”*⁵³;
- nenin 186 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i dokumentave”*, si dhe nenin 287 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”*⁵⁴; nenin 257/a/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin ligjor*

⁴⁶ Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

⁴⁷ Vendimi nr. 450-1261, datë 19.03.2018

⁴⁸ Vendimi nr. 383-1003, datë 06.03.2018; Vendimi nr. 1491-4267, datë 18.09.2018

⁴⁹ Vendimi nr. 900-2274, datë 07.05.2019

⁵⁰ Vendimi nr. 1007-2567, datë 20.05.2019; Vendimi nr. 1268-3324, datë 27.06.2019

⁵¹ Vendimi nr. 1226-3177, datë 20.06.2019

⁵² Vendimi nr. 1297-3450, datë 12.07.2018

⁵³ Vendimi nr. 1489-4269, datë 18.09.2018

⁵⁴ Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

*për deklarim*⁵⁵; nenin 186 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Falsifikimi i dokumentave*⁵⁶.

Në vendimet e tjera me objekt *“Lirim para kohe me kusht”*, *“Vleftësim arresti dhe caktim mase”* dhe *“Ulje dënimi”* identifikon dispozitat materiale në funksion të përcaktimit të rrezikshmërisë së të pandehurit apo të dënuarit:

- nenin 137/1 të K. Penal, në lidhje me veprën penale përkatësisht *“Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike*⁵⁷; nenin 283/2 të K. Penal në lidhje me veprën penale *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve*⁵⁸.

Referohen dispozita pjesës së përgjithshme të Kodit Penal:

- nenin 1/b të K. Penal në lidhje me objektin e legjislacionit penal, nenin 1/c të K. Penal në lidhje me parimet në të cilat mbështetet K. Penal, nenin 64 të K. Penal në lidhje me lirimin me kusht⁵⁹;
- nenin 14 të K. Penal në lidhje me fajësinë⁶⁰;
- nenet 12, 17, 25, 26, 27 të K. Penal, dispozita në të cilat legjislatori ka parashikuar përgjegjësinë penale, bashkëpunimin, bashkëpunëtorët dhe përgjegjësinë e tyre⁶¹;
- nenin 22 të K. Penal në lidhje me tentativën⁶²;
- nenin 32 të K. Penal në lidhje me dënimin me burgim⁶³;
- nenin 66 të K. Penal në lidhje me parashkrimin e ndjekjes penale⁶⁴;
- nenin 55 të K. Penal në lidhje me bashkimin e dënimeve, nenin 71 të K. Penal në lidhje me amnistinë⁶⁵

Referohen dispozitat proceduriale të K. Pr. Penale:

- nenin 69, 74 dhe 477 të K. Pr. Penale në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës dhe nenin 13 të K. Pr. Penale në lidhje me përbërjen e trupin gjykues që shqyrton kërkesën⁶⁶;

⁵⁵ Vendimi nr. 192-5201, datë 11.12.2017

⁵⁶ Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017

⁵⁷ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

⁵⁸ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

⁵⁹ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

⁶⁰ Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

⁶¹ Vendimi nr. 1226-3177, datë 20.06.2019; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019; Vendimi nr. 450-1261, datë 19.03.2018; Vendimi nr. 383-1003, datë 06.03.2018

⁶² Vendimi nr. 1268-3324, datë 27.06.2019; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

⁶³ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

⁶⁴ Vendimi nr. 450-1261, datë 19.03.2018; Vendimi nr. 383-1003, datë 06.03.2018; Vendimi nr. 1007-2567, datë 20.05.2019

⁶⁵ Vendimi nr. 98-850, datë 20.02.2019

⁶⁶ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

- nenin 75/a të K. Pr. Penale të ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 në lidhje me kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar⁶⁷ ;
- nenin 4 të K. Pr. Penale në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë, nenin 328 të K. Pr. Penale në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose çështjes, nenet 329/a dhe 329/b të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës ose çështjes⁶⁸ ;
- nenin 13/2 pika ç të K. Pr. Penale në lidhje me shqyrtimin e çështjes me trup gjykues të përbërë nga një gjyqtar, nenet 15-18 të K. Pr. Penale në lidhje me pajtueshmërinë e trupit gjykues, nenet 49/1f, 49/a dhe 332/b të K. Pr. Penale në lidhje me të drejtën e mbrojtjes së të pandehurit gjatë seancës paraprake, nenin 69 të K. Pr. Penale në lidhje me juridiksionin, nenin 143 të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë e njoftimeve, nenet 202-206 të K. Pr. Penale në lidhje me kontrollin e banesës, nenin 298 të K. Pr. Penale në lidhje me kontrollimet, nenin 324 të K. Pr. Penale në lidhje me njoftimin për përfundimin e hetimeve, nenin 327 dhe 331 të K. Pr. Penale në lidhje me kriteret formale dhe thelbësore që duhet të plotësojë kërkesa për dërgim në gjyq, nenin 328 të K. Pr. Penale në lidhje me rastet e pushimit të çështjes penale apo akuzës, nenin 332 të K. Pr. Penale në lidhje me seancën paraprake, nenin 332/ë në lidhje me përmbajtjen e fashikullit të gjykimit⁶⁹ ;
- nenin 2 të K. Pr. Penale në lidhje me detyrimin për respektimin e normave procedurale penale, nenin 128 të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë absolute të akteve, nenin 129 të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë relative të akteve procedurale, nenin 143 të K. Pr. Penale në lidhje me pavlefshmërinë e njoftimeve, nenin 279 të K. Pr. Penale në lidhje me detyrimin për të ruajtur sekretin, nenin 325 të K. Pr. Penale në lidhje me të drejtën e ankimit ndaj vendimit të zgjatjes së afatit të hetimit⁷⁰ ;
- nenin 465 të K. Pr. Penale në lidhje me llogaritjen e paraburgimit dhe dënimeve të shlyera⁷¹ ;
- nenet 202-206 të K. Pr. Penale në lidhje me kontrollin e banesës, nenin 298 të K. Pr. Penale në lidhje me kontrollimet⁷² ;
- nenet 228 dhe 229 të K. Pr. Penale në lidhje me kushtet dhe kriteret për caktimin e masës së sigurimit, nenin 230 të K. Pr. Penale në lidhje me rrethanat e caktimit të masës së sigurimit “*Arrest në burg*”, nenin 234 të K. Pr. Penale në lidhje me masën e sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*”, nenet 251, 252 dhe 258 të K. Pr. Penale në lidhje me vleftësimin e arrestimit në flagrancë⁷³ ;
- nenin 278 të K. Pr. Penale në lidhje me kompetencat e gjykatës së shkallës së parë në fazën e hetimeve paraprake, nenin 291 të K. Pr. Penale në lidhje me ankimin ndaj vendimit të mosfillimit⁷⁴ ;
- nenin 328 të K. Pr. Penale në lidhje me rastet e pushimit të akuzës ose çështjes, nenet 329/a dhe 329/b të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për pushimin e akuzës ose çështjes⁷⁵.

⁶⁷ Vendimi nr. 192-5201, datë 11.12.2017

⁶⁸ Në të gjitha vendimet e pushimit të çështjes penale

⁶⁹ Në të gjitha vendimet me objekt dërgim i çështjes në gjyq

⁷⁰ Vendimi nr. 1297-3450, datë 12.07.2018

⁷¹ Vendimi nr. 98-850, datë 20.02.2019

⁷² Vendimi nr. 1226-3177, datë 20.06.2019

⁷³ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

⁷⁴ Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017

⁷⁵ Në të gjitha vendimet me objekt pushim i çështjes

Referohen dispozita me karakter material dhe procedural, të cilat janë drejtpërdrejt të aplikueshme për zgjidhjen e çështjes, krahas dispozitave të K. Penal dhe K.Pr.P, konkretisht referon:

- nenin 4 të ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, në lidhje me llojet e armëve, si dhe nenin 3 të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, në lidhje me përkufizimin e dhunës në familje⁷⁶;
- ligjin nr. 7975, datë 26.07.1995 “Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope”⁷⁷;
- ligjin nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, si dhe ligjin nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e dënimeve penale” i ndryshuar⁷⁸;
- ligjin nr. 9861, datë 24.08.2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror” i ndryshuar⁷⁹;
- nenet 63,71, 54 dhe 72 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1988 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” në lidhje me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, në lidhje me masat disiplinore, si dhe në lidhje me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të insitucionit ku kërkuesi vuan dënimin në shqyrtimin e kërkesës për uljen e dënimit⁸⁰;
- nenin 31/6 të ligjit nr. 8331, datë 21.04.1988 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” në lidhje me përbërjen e trupin gjykues që shqyrton kërkesën⁸¹;

Krahas dispozitave të Kodit Penal dhe ligjeve të posaçme si më sipër, gjyqtari ka identifikuar dhe referuar si ligj të zbatueshëm edhe një sërë dispozitash të Kushtetutës dhe akteve ndërkombëtare që përbëjnë burim të së drejtës:

- nenin 7 të KEDNJ-së dhe nenin 29 të Kushtetutës (të cilin ka pasqyruar ndryshimet sipas ligjeve 144/2013, 98/2014, 135/2015 dhe 82/2016) lidhur me parimin “askush nuk mund të deklarohet fajtor për një vepër penale, e cila nuk konsiderohet e tillë me ligj në kohën e kryerjes së saj”⁸² ;
- nenin 6 të KEDNJ dhe nenin 30 të Kushtetutës në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë⁸³ ;
- nenin 27 të Kushtetutës në lidhje me lirinë personale⁸⁴ ;
- nenin 39 të Kushtetutës në lidhje me mosdënimin pa ligj⁸⁵;
- nenin 42 të Kushtetutës në lidhje me të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor, nenin 135 të Kushtetutës në lidhje me gjykatat, nenin 148 të Kushtetutës në lidhje me funksionin e prokurorisë⁸⁶ ;

⁷⁶ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

⁷⁷ Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

⁷⁸ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017; Vendimi nr. 98-850, datë 20.02.2019

⁷⁹ Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

⁸⁰ Vendimi nr. 759-5899, datë 19.11.2019

⁸¹ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

⁸² Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

⁸³ Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

⁸⁴ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

⁸⁵ Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

⁸⁶ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018; Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017

- nenin 53 të Kushtetutës në lidhje me mbrojtjen e veçantë që garantohet për familjen⁸⁷.

Sa i përket konfliktit të normave, në çështjet e shortuara apo të përzgjedhura nga gjyqtari nuk rezultojnë konflikte të normave.

Gjyqtari e vlerëson si shumë të lartë aftësinë e tij profesionale për të përcaktuar faktet e çështjes, identifikuar natyrën e saj, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave duke u shprehur se *“Përsa i përket aftësisë për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjit të zbatueshëm dhe konfliktin e normave vlerësoj se në çdo rast kam identifikuar në mënyrë të qartë faktet konkrete të çështjes, dhe ligjin e zbatueshëm sipas natyrës së çështjes (penale themeli, kërkesa penale në fazën e ekzekutimit si dhe kërkesa të tjera penale të llojeve të ndryshme), pavarësisht përcaktimit të normave ligjore të identifikuar nga palët.*

Referuar përmbajtjes së vendimeve gjyqësore të shpallura gjatë periudhës së vlerësimit, por edhe vendimeve të përzgjedhura për vlerësim, vlerësoj se evidentohet në mënyrë të qartë përcaktimi i fakteve të çështjes dhe natyrës së saj, ligjit të zbatueshëm, si dhe analiza e konfliktit të normave në ato raste kur ka pasur. Në të gjitha ato raste kur çështjet gjyqësore janë karakterizuar nga kompleksiteti i fakteve apo normave, jam përpjekur të analizoj në pjesën arsyetuese ligjin e zbatueshëm (p.sh. ligji i kohës) dhe arsyet e zbatimit të tij në rastin konkret. Gjithashtu, në ato raste kur ka patur konflikt ndërmjet normave, kam analizuar normën e zbatueshme bazuar në standardet e vendosura nga Gjykata Kushtetuese në Vendimin Nr. 2 datë 03.02.2010, në lidhje me zbatimin e parimit të hierarkisë së normave.

Kjo rezulton edhe nga përzgjedhja e dy vendimeve gjyqësore penale bashkëlidhur formularit, ku pjesë e arsytimit të vendimit gjyqësor është edhe identifikimi dhe interpretimi i normës/normave ligjore të zbatueshme në secilin rast. Përcaktimi i ligjit të zbatueshëm në raport me faktet konkrete të çështjes vlerësoj se është shumë i rëndësishëm edhe në drejtim të zbatimit të parimeve kryesore në të drejtën penale dhe procedurale penale, sikurse zbatimi i ligjit penal favorizues në të drejtën penale materiale dhe procedurale, në këndvështrim edhe të ndryshimeve ligjore dhe kohës së hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve.”

KONKLUZIONI

Në tërësi, gjyqtari shfaq aftësi shumë të mira në drejtim të paraqitjes dhe analizës së plotë të fakteve të çështjes, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, ashtu edhe të fakteve thelbësore të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të

⁸⁷ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

zgjdhjes së çështjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*procedurale dhe materiale penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet gjithmonë në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore me natyrë procedurale apo materiale, citohen ose referohen, duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre abstrakt dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Nga burimet e vlerësimit konstatohet se përgjithësisht gjyqtari përqendrohet në interpretimin e normës, të shoqëruar në disa raste edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë, të Gjykatës Kushtetuese apo të GJEDNJ, duke e zbërthyer normën në raport me faktet e çështjes, për të shkuar si rrjedhojë logjike në konkluzionet e arritura lidhur me zbatimin e saj në rastet konkrete.

Gjyqtari kryesisht përdor interpretimin *teleologjik*, duke identifikuar qëllimin e normës, por edhe interpretimin *literal* dhe *sistematik* të normave, duke përjasur kuptimin e normës me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Në vendimet burim vlerësimi gjyqtari interpreton dispozitat materiale në funksion të cilësimit juridik të veprës penale për të cilën kërkohet dërgimi në gjyq apo gjykimi i të pandehurit dhe të përcaktimit të përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj, duke bërë zbërthimin e normave të pjesës së posaçme të Kodit Penal. Gjyqtari interpreton në nivel teorik normën relevante të K.Penal, duke bërë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me

elementët dallues të veprës penale, e në vijim, duke e përqsur me faktet e provuara në gjykim, nxjerr konkluzionin në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal dhe përgjegjësinë penale të autorit.⁸⁸

Në vendimet burim vlerësimit gjyqtari interpreton dispozitat e pjesës së posaçme dhe të përgjithshme të Kodit Penal në lidhje me cilësimin e veprës penale, elementët e saj (që përgjithësisht ndalet gjatë në interpretimin e tyre për çdo vepër penale në gjykim), moshën për përgjegjësi penale, bashkëpunimin, pezullimin e dënimit, dënimin alternativ etj. Më konkretisht gjyqtari analizon:

- nenin 278/1, 278/3 të K. Penal *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”* duke sjellë në vëmendje fillimisht ndryshimet ligjore që ka pësuar kjo dispozitë në kronologji. Gjithashtu, ndalet në analizën e detajuar të elementëve të saj, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të saj. Në veçanti, ndalet në analizën dhe evidentimin e dallimit midis termave *“banesë”, “mjedise publike”* dhe *“mjedise të hapura për publikun”*, si dhe zhvillon analizën juridike të veprave penale *“Kanosja”, “Prishja e qetësisë publike”* dhe *“Moskallëzimi i krimin”* parashikuar nga nenet 84, 274 dhe 300 të K. Penal⁸⁹;
- nenin 130/a/2 i K. Penal *“Dhuna në familje”* dhe nenin 278/3 i K. Penal *“Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit”* duke trajtuar në mënyrë të detajuar elementët e saj, përkatësisht objektin, anën objektive, subjektin dhe anën subjektive të saj, duke referuar për këtë qëllim edhe në ligjin e posaçëm nr. 9669, datë 18.12/2006 *“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”* dhe ligjin nr. 74/2014, në lidhje me parashikimin për llojet e armëve⁹⁰;
- nenin 283 i K. Penal *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”* duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të saj, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të saj, duke sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën unifikuese për këtë qëllim. Në këtë kuadër, i kushton vëmendje të veçantë analizës së togfjalëshit *“në doza të vogla”*.⁹¹;
- nenin 189/2 *“Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave apo vizave”*, dhe nenin 297 i K. Penal *“Kalim i paligjshëm i kufirit shtetëror”*, duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të tyre, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive⁹²;
- nenin 137/1 të K. Penal *“Vjedhja e energjisë elektrike”*, duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të saj, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të saj⁹³;
- nenin 186/1 i K. Penal *“Falsifikimi i dokumentave”*, duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të saj, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të saj, duke mbajtur në konsideratë edhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë në këtë drejtim⁹⁴;

⁸⁸ Në të gjitha vendimet penale të themelit konstatohet analiza teorike e dispozitave penale në lidhje me cilësimin juridik të faktit penal, para aplikimit mbi faktet e çështjes.

⁸⁹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018

⁹⁰ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

⁹¹ Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

⁹² Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

⁹³ Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017

⁹⁴ Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

- nenin 151 i K. Penal *“Shkatërrimi i pronës me zjarr”* dhe nenin 161 i K. Penal *“Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”*, duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të tyre, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive⁹⁵ ;
- nenin 134/1 i K. Penal *“Vjedhja”* duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të saj, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të saj⁹⁶ ;
- nenin 287 i K. Penal *“Pastrimi i produkteve të veprës penale”* duke u ndalur në elementët përkatës për secilën prej tyre⁹⁷ ;
- nenin 291 i K. Penal *“Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”* duke u ndalur në analizën e detajuar të elementëve të saj, përkatësisht objektit, anës objektive, subjektit dhe anës subjektive të saj⁹⁸ ;
- nenin 63 të K.Penal alternativën e dënimit me burgim *“Pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim dhe kryerja e një pune në interes publik”*, duke evidentuar kushtet që duhet të plotësohen për aplikimin e tij. Gjithashtu, sjell në vëmendje Rekomandimin nr. R (99) 22 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 15.05.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë *“Mbi dënimin me kusht”*⁹⁹ ;
- nenin 64 të K. Penal, evidenton kushtet që duhet të plotësohen referuar legjislacionit penal për efekt të pranimit të kërkesës për lirim me kusht dhe konkretisht: i) arsyet e veçanta, të cilat vërtetojnë se i dënuari me sjelljen dhe punën e tij tregon se me dënimin e vuajtur është arritur qëllimi për edukimin e tij; ii) qëndrimi i personit të dënuar ndaj veprës penale dhe ndaj viktimës apo familjes së viktimës; iii) natyra e veprës penale të kryer; iv) planet konkrete të kërkuesit për të mundësuar riintegrimin e tij të plotë pas lirimit; v) të ketë vuajtur ¼ e dënimit të dhënë për krime me masë dënimi nga 5 deri në 35 vjet burgim, pa llogaritur këtu kohën e fituar me amnisti ose falje; vi) të mos jetë përsëritës; vii) të mos jetë dënuar për krime që parashikohen nga neni 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo 100/3 të K. Penal; viii) kërkesa të mos jetë riparaqitur pa kaluar në minimum 6 muaj nga dita që vendimi për rrëzimin e kërkesës për lirim me kusht ka marrë formë të prerë¹⁰⁰;
- nenin 59 të K.Penal lidhur me pezullimin e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim si formë alternative të vuajtjes së dënimit duke analizuar elementët thelbësorë të aplikimit të tij, si dhe duke e analizuar në raport me rrethanat e rastit konkret (duke sjellë në vëmendje edhe Rekomandimin nr. R (99) 22 të Komitetit të Ministrave për shtetet anëtare në lidhje me mbipopullimin e burgjeve)¹⁰¹ si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 14.03.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë në lidhje me vlerat interpretuese që ai ka sa i takon *“rrezikshmërisë së veprës penale”*, si dhe Udhëzimin nr. 5, datë 15.05.1979 të Plenumit të Gjykatës së Lartë *“Mbi dënimin me kusht”*¹⁰².

⁹⁵ Vendimi nr. 900-2274, datë 07.05.2019

⁹⁶ Vendimi nr. 1268-3324, datë 27.06.2019

⁹⁷ Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

⁹⁸ Vendimi nr. 1489-4269, datë 18.09.2018

⁹⁹ Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018

¹⁰⁰ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

¹⁰¹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018

¹⁰² Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017.

Në ato raste kur në zgjidhjen e çështjes është i nevojshëm referimi në ligje të posaçëm, gjyqtari zbaton dhe referon në interpretim edhe në dispozita të ligjeve të posaçme si psh:

- nenin 63 të ligjit nr.8328, datë 16.014.1998: "*Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve*", duke listuar kriteret që duhet të provojë kërkuesi, i cili i është drejtuar gjykatës me kërkesë me objekt "*ulje dënimi*" në momentin e paraqitjes së kërkesës: së 1) kërkuesi duhet të jetë i dënuar; 2), kërkuesi duhet të zbatojë rregullat e institucionit ku vuan dënimin penal me burgim; 3), kërkuesi duhet të ketë sjellje shembullore në veprimtaritë trajnuese, duke dhënë prova për riintegrimin në shoqëri; 4), kërkuesi duhet të mos ketë përfituar ulje dënimi gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit ¹⁰³. Por nga përmbajtja e vendimit gjyqësor, por edhe provave të paraqitura, rezulton se gjyqtari në interpretimin e tij nuk ka dhënë një kuptim të saktë dhe të rregullt të normës ligjore, referuar kjo përmbajtjes së dispozitës si dhe qëndrimet e mbajtura nga praktika gjyqësore lidhur me shqyrtimin e këtyre kërkesave. Në këtë rast gjyqtari nuk ka bërë një interpretim të përcaktimit ligjor që kërkuesi/ i dënuari nuk duhet të kishte përfituar ulje dënimi gjatë dymbëdhjetë muajve të fundit. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari nuk ka bërë një interpretim të plotë të kriterëve ligjore të cituara prej tij, në raport me faktet e çështjes të përshkruara prej tij apo që ndodheshin në dosjen gjyqësore.

Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale gjyqtari i jep rëndësi interpretimit të normës së zbatueshme si në rastet kur trajtohen çështje të procedurës, ashtu edhe në rastet kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel, si p.sh çështjet penale të seancës paraprake. Konkreisht gjyqtari interpreton (në mënyrë literale/sistematike/logjike):

- nenin 327/2-4 dhe nenin 331/3 të K. Pr. Penale në lidhje me kërkesën për gjykim duke marrë në analizë aspektet formale dhe thelbësore të. Në lidhje me elementët thelbësore të kërkesës, evidentohet kryerja e hetimeve në mënyrë të plotë, moskonstatimi i rasteve të pavlefshmërisë absolute të akteve apo papërdorshmërisë së provave, cilësimi i drejtë ligjor i faktit penal, si dhe mosverifikimi i ndonjë prej shkaqeve të pushimit të çështjes penale¹⁰⁴ ;
- nenin 324 dhe 325 të K. Pr. Penale në lidhje me të drejtën e njoftimit të të pandehurit për vendimin e prokurorit për zgjatjen e afatit të hetimeve, duke u ndalur tek pasoja e mosnjoftimit, duke marrë në analizë nëse passjell pavlefshmëri absolute, relative apo asnjë prej tyre. Në këtë kuadër, analizon edhe konfliktin që krijohet ndërmjet të drejtës për njoftim dhe parimit të mbrojtjes së sekretit hetimor¹⁰⁵ ;
- konceptin e masave të sigurimit, me fokus në kushtet dhe kriteret në lidhje me caktimin e tyre. Kështu, në lidhje me kushtet që legjitimojnë caktimin e masës së sigurimit, sqarohet se referuar nenit 228 të K. Pr. Penale duhet të verifikohet: ekzistenca e një dyshimi të arsyeshëm të bazuar në prova se vepra penale ka ndodhur dhe se e ka kryer personi nën hetim; mosekzistenca e asnjë shkak padënueshmërie; ekzistenca e të paktën një prej rrethanave të parashikuara nga neni 228/3 i K. Pr. Penale. Në lidhje me kriteret për caktimin e masës së sigurimit, sqarohet se referuar nenit 229 të K. Pr. Penale duhen mbajtur parasysh: përshtatshmëria e masës së sigurimit me shkallën e nevojave të sigurimit që kërkohen në rastin

¹⁰³ Vendimi nr. 759-5899, datë 19.11.2019.

¹⁰⁴ Në të gjitha vendimet me objekt "Dërgim në gjyq".

¹⁰⁵ Vendimi nr. 1297-3450, datë 12.07.2018.

- konkret; ruajtja e një raporti të drejtë midis rëndësisë së faktit dhe sanksionit që parashikohet për veprën penale konkrete me llojin e masës së sigurimit, rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parashikuara nga K. Penal¹⁰⁶ ;
- konceptin e arrestit në flagrancë si një nga rastet e kufizimit të lirisë personale të individit, duke evidentuar se ligjshmëria e këtij kufizimi kushtëzohet nga zbatimi i neneve 251, 252 dhe 258 të K. Pr. Penale¹⁰⁷ ;
 - konceptin e ndjekjes penale, duke u ndalur veçanërisht në kuptimin dhe parimet e realizimit të saj. Gjithashtu, trajton rëndësinë e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorisë, kontroll i cili ushtrohet në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të¹⁰⁸ ;
 - nenin 75/a të K. Pr. Penale dhe dispozitave kalimtare të ligjit nr. 35/2017 lidhur me zbatimin e tij, për të konkluduar në lidhje me kompetencën lëndore të gjykatës. Gjithashtu trajton konceptin e të dëmtuarit nga vepra penale¹⁰⁹ ;

Në lidhje me aftësinë për të përdorur jurisprudencën relevante, rezulton se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur gjerësisht jurisprudencën relevante (*vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimet e Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ*), në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit, kryesisht në rastet si më poshtë:

- Pasqyron jurisprudencën e GJEDNJ, përkatësisht vendimin mbi çështjen “Contrada kundër Italy (3)” në lidhje me parimin e mosdënimit pa ligj, vendimin mbi çështjen “Cantoni kundër Francës”, “Coëme and Others kundër Belgjikës”, “Sud Fondi S.r.l. and Others kundër Italy”, dhe “Ashlarba kundër Georgia” në lidhje me kuptueshmërinë e normës penale, vendimin mbi çështjen “Del Río Prada kundër Spanjës”, “S.Ë. kundër the United Kingdom” dhe “C.R. kundër the United Kingdom” në lidhje me ndihmën ligjore të nevojshme për subjektet për të kuptuar veprimet/mosveprimet të cilat aktivizojnë përgjegjësinë penale, vendimin mbi çështjen “Rohlena kundër the Czech Republic” në lidhje me misionin kushtetues të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për kualifikimin e faktit penal, vendimin mbi çështjen “Ashlarba kundër Georgjisë” në lidhje me nevojën për interpretimin e ligjit, si dhe vendimin mbi çështjen “Dallas kundër The United Kingdom” dhe “Martirosyan kundër Armenisë” në lidhje me parimin e mosdënimit pa ligj¹¹⁰ ;
- jurisprudencën e GJEDNJ, përkatësisht vendimin në çështjen Giulani dhe Gaggio kundër Italisë në lidhje me parimin “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*”¹¹¹, vendimet në çështje Minelli kundër Zvicrës, John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar dhe Telfner kundër Austrisë në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë¹¹² ;
- jurisprudencën e GJEDNJ, përkatësisht vendimet “*Tomasi kundër Francës*” në lidhje me nevojën për vazhdimin e zbatimit të masave të sigurimit¹¹³
- Referon jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese :

¹⁰⁶ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

¹⁰⁷ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

¹⁰⁸ Në vendimet me object “*kundërshtim vendim pushimi*”

¹⁰⁹ Vendimi nr. 192-5201, datë 11.12.2017

¹¹⁰ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

¹¹¹ Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

¹¹² Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

¹¹³ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

- vendimin nr. 5/2001 në lidhje me rëndësinë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese¹¹⁴
- vendimin nr. 9/2016 në lidhje me shfuqizimin e paragrafit të pestë dhe të gjatë të nenit 278 të K. Penal¹¹⁵,
- vendimin nr. 4/2004, nr. 9/2004, nr. 19/2008, nr. 23/2009 dhe nr. 19/2012 në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë¹¹⁶ ;
- vendimin nr. 3/2008 në lidhje me parimin e ligjshmërisë, vendimin nr. 14/2008 në lidhje me kontrollin gjyqësor ndaj veprimeve të prokurorisë dhe vendimin nr. 5/2009 në kuadër të harmonizimit të K. Pr. Penale me amendamentet e Kushtetutës¹¹⁷
- vendimin nr. 14/2007 në lidhje me të drejtën për proces të rregullt ligjor¹¹⁸,
- vendimin nr. 35/2005 dhe nr. 1/2014 në lidhje me ligjin penal favorizues¹¹⁹,
- vendimin nr. 1/2014 dhe 16/2010 në lidhje me amnistinë¹²⁰ ;
- vendimin nr. 1/2011, 19/2011 dhe 47/2012 në lidhje me rëndësinë e legjislacionit penal dhe dënimit¹²¹ ;
- vendimin nr. 47/2011 dhe nr. 57/2012 në lidhje me parimin e prezumimit të pafajësisë¹²² ;
- Referon jurisprudencën unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë :
 - vendimin nr. 1/2008 në lidhje me veprën penale *“Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”*¹²³
 - vendimin nr. 2, datë 29.01.2003 në lidhje me gjykimin e shkurtuar¹²⁴
 - vendimin nr. 4, datë 15.04.2011 në lidhje me bashkëpunimin¹²⁵;
 - vendimin nr. 7/2011 në lidhje me revokimin/zëvendësimin e masave të sigurimit¹²⁶ dhe në lidhje me rëndësinë e sjelljes së autorit para dhe pas kryerjes së veprës penale¹²⁷ ;
 - vendimin nr. 7, datë 14.10.2011 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë” në lidhje me konceptin *“dyshim i arsyeshëm”*¹²⁸ ;
 - vendimin nr. 2, datë 25.05.2015 në lidhje me lirimin me kusht¹²⁹ ;
 - vendimin nr. 2/2013 në lidhje me gjykimet me objekt kundërshtimin e vendimit të pushimit¹³⁰

¹¹⁴ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

¹¹⁵ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

¹¹⁶ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

¹¹⁷ Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

¹¹⁸ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

¹¹⁹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

¹²⁰ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017; Vendimi nr. 98-850, datë 20.02.2019

¹²¹ Vendimi nr. 1377-3691, datë 25.07.2018

¹²² Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

¹²³ Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019

¹²⁴ Thuajse në të gjitha vendimet penale

¹²⁵ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1082-2759, datë 28.05.2019; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

¹²⁶ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018

¹²⁷ Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

¹²⁸ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

¹²⁹ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

¹³⁰ Në vendimet me objekt *“kundërshtim vendim pushimi”*

- Referon jurisprudencë jounifikuese të Gjykatës së Lartë :
 - vendimin nr. 6, datë 30.09.2011 të Kolegjeve të Bashkuara në lidhje me termin “pasojë e rëndë” që parashikon neni 278 i K. Penal¹³¹;
 - vendimin nr. 78, datë 27.04.2016 të Kolegjit Penal në lidhje me togfjalëshin “pasojë e rëndë” për efekt të anës objektive të veprës penale “Shkatërrimi i pronës nga pakujdesia”, parashikuar nga neni 161 i K. Penal¹³² ;
 - vendimet nr. 99, datë 09.04.2014 dhe nr. 151, datë 18.06.2014 të Kolegjit Penal në lidhje me nenin 59 të K. Penal¹³³ ;
 - vendimin nr. 132, datë 12.10.2011 të Kolegjit Penal në lidhje me shuarjen e masave të sigurimit¹³⁴
 - vendimin nr. 209, datë 03.07.2013 të Kolegjit Penal në lidhje me veprën penale të parashikuar nga neni 278/3 i K. Penal¹³⁵ ;
 - vendimin nr. 510, datë 12.11.2018 të Kolegjit Penal në lidhje me objektin e veprës penale parashikuar nga neni 186 i K. Penal, vendimet nr. 617, datë 16.06.2010, nr. 288, datë 07.11.2012, nr. 113, datë 27.03.2013 dhe nr. 186, datë 05.06.2013 të Kolegjit Penal në lidhje me anën objektive të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i K. Penal, si dhe vendimin nr. 5, datë 12.01.2011 të Kolegjit Penal në lidhje me anën subjektive të veprës penale të parashikuar nga neni 186 i K. Penal¹³⁶ ;
 - vendimet nr. 146, datë 23.05.2012, nr. 7, datë 16.01.2013 dhe nr. 196, datë 04.07.2012 të Kolegjit Penal në lidhje me kontrollin gjyqësor ndaj vendimit të mosfillimit apo pushimit¹³⁷
 - vendimin nr. 112, datë 26.09.2005 në lidhje me caktimin e masave të sigurimit¹³⁸ ;
 - vendimin nr. 10, datë 10.01.2012, nr. 72, datë 07.03.2012, nr. 125, datë 02.05.2012, nr. 25, datë 05.02.2014, nr. 119, datë 23.04.2014, nr. 230, datë 19.12.2014 dhe nr. 75, datë 12.03.2014 të Kolegjit Penal në lidhje me institutin e lirimit me kusht¹³⁹ ;
 - vendimin nr. 137, datë 26.10.2011 të Kolegjit Penal në lidhje me ndjekjen penale¹⁴⁰ ;
 - vendimin nr. 00-2016-2049, datë 16.11.2016 në lidhje me nenin 55 të K. Penal, i cili disiplinon bashkimin e dënimeve¹⁴¹.

Gjithashtu gjyqtari referon edhe literaturë juridike, përkatësisht Peter Badura, Staatsrecht, Black’s Laë Dictionary, Barron’s Laë Dictionary¹⁴².

¹³¹ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017;

¹³² Vendimi nr. 900-2274, datë 07.05.2019

¹³³ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1081 (2852), datë 11.06.2018; Vendimi nr. 1508 (4316), datë 20.09.2018; Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017

Vendimi nr. 680-3826, datë 28.09.2017

¹³⁴ Vendimi nr. 1376-3695, datë 25.07.2018

¹³⁵ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017; Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017

¹³⁶ Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

¹³⁷ Në vendimet me objekt “kundërshtim vendim pushimi”

¹³⁸ Vendimi nr. 30, datë 19.01.2017

¹³⁹ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

¹⁴⁰ Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017

¹⁴¹ Vendimi nr. 98-850, datë 20.02.2019

¹⁴² Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018;

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari njej, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimin e mosdënimit pa ligj dhe fuqisë prapavepruese të ligjit penal, parimin e procesit të rregullt ligjor parimin e prezumimit të pafajësisë, si dhe parimet për caktimin e dënimit¹⁴³;
- parimet bazë të K. Penal, përkatësisht parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit, si dhe të humanizmit¹⁴⁴;
- parimin “*nullum crimen, nulla poena sine causa*”, si dhe parimet për caktimin e dënimit¹⁴⁵;
- parimin e ligjshmërisë¹⁴⁶, parimet kushtetuese të shtetit të së drejtës, të barazisë para ligjit, të drejtësisë në caktimin e fajësisë dhe dënimit, si dhe të humanizmit¹⁴⁷;
- parimin e prezumimit të pafajësisë, “*përtej çdo dyshimi të arsyeshëm*” dhe “*çdo dyshim në favor të të pandheurit*”¹⁴⁸.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e saj për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave në shkallë shumë të lartë. Ai shprehet se: “*Në analizë tërësore të vendimeve gjyqësore të shpallura gjatë periudhës 2017-2019, vlerësoj se aftësia e interpretimit të ligjit ka qenë në nivele të larta. Në të gjitha vendimet gjyqësore, nuk jam mjaftuar vetëm me citimin e dispozitës ligjore të zbatueshme, por kam interpretuar dhe analizuar atë në kuadër të fakteve të çështjes. Lidhur me aftësinë në interpretimin e ligjit në zgjidhjen e çështjeve konkrete, vlerësoj se pothuajse në çdo rast identifikimi i normës/normave ligjore, në të drejtën penale materiale/dhe/ose procedurale, është shoqëruar nga ana ime në arsytimin e vendimeve gjyqësore edhe me interpretimin e tyre, sipas rastit interpretim gramatikor, sistematik në raport me normat e tjera, si dhe interpretim logjik të normës ligjore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet gjyqësore, në interpretim të normës konkrete, kam zbatuar edhe parimet e përgjithshme të së drejtës materiale dhe procedurale, të aplikueshme në rastin konkret. Këto parime janë zbatuar edhe në ato raste kur ligji ka munguar, ka qenë i paqartë apo ka patur kundërthënie, duke i dhënë zgjidhje çështjes konkrete. Nga ana tjetër, vlerësoj se vendimet gjyqësore, janë të pasura edhe me praktikë gjyqësore të detyrueshme (vendime të Gjykatës Kushtetuese, vendime të GJEDNJ-së në rastet që lidhen krejtësisht me zbatimin e nenit 6 të KEDNJ-së “ e drejta për një proces të rregullt*

¹⁴³ Vendimi nr. 515 (2676), datë 22.06.2017

¹⁴⁴ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

¹⁴⁵ Vendimi nr. 617 (3267), datë 27.07.2017; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

¹⁴⁶ Vendimi nr. 31-1212, datë 21.03.2017; Vendimi nr. 28-1011, datë 06.03.2018

¹⁴⁷ Thuajse në të gjitha vendimet themeli

¹⁴⁸ Vendimi nr. 439-2245, datë 29.05.2017; Vendimi nr. 1758 (5179), datë 17.10.2019

ligjor”, si dhe neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Vendime Unifikuese të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë), në ato raste kur janë relevante për çështjen, si dhe me praktikë gjyqësore ndihmëse (Vendime të Kolegjit Civil dhe Penal të Gjykatës së Lartë). Citimi i këtyre të fundit është përdorur jo vetëm si autoritet bindës në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, por edhe si etalon i ndjekjes së të njëjtës praktike gjyqësore për çështje të njëjta. Në këtë pjesë, dua të theksoj faktin se kam treguar kujdesin maksimal për të citur praktikë gjyqësore në ato çështje për të cilat, ka patur praktikë gjyqësore relevante, duke mos e ngarkuar vendimin gjyqësor me praktikë jo relevante.”.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të dispozitave të ligjit material dhe procedural, duke bërë kryesisht një interpretim abstrakt të normave që gjejnë zbatim në rastin konkret, si dhe duke i integruar edhe me provat e marra. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimin e ligjit si atë abstrakt ashtu edhe në raport me provat e marrë në shqyrtim, duke i dhënë normës një interpretim jo të drejtë ligjor, referuar praktikës së konsoliduar gjyqësore. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar gjërësisht praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ si dhe ka treguar kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjeve konkrete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit në lidhje me treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, është “Mbi mesatare” dhe pikëzohet me 20 pikë.

1.B ARSYETIMI LIGJOR

1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballet gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur

arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar¹⁴⁹.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza), duke u shoqëruar me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse, pa krijuar konfuzion për përmbajtjen apo kuptimin e tyre¹⁵⁰. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose kuptohet qartë nga konteksti i arsytimit.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (*jo gjithmonë shkronjat "ë" dhe "ç"*). Përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera, sipas përkatësisë. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre apo të kontekstit në të cilin përdoren.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Të gjitha vendimet janë organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj dhe me paragrafë duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike dhe vazhdimësisë së mendimit.

Gjyqtari e ka vlerësuar treguesin "*qartësia, konçiziteti dhe kuptueshmëria e vendimit*" në shkallë shumë të lartë. Ai shprehet se: "*Përsa i përket arsytimit ligjor të vendimeve gjyqësore, në çdo rast, pavarësisht volumit të punës dhe ngarkesës së madhe në punë për vitet 2017- 2019, vlerësoj se jam përpjekur maksimalisht për të përdorur në çdo rast në*

¹⁴⁹ Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

¹⁵⁰ Evidentohet përdorimi i termave latinë si: "*nullum crimen, nulla poena sine causa*"; "*condicio sine qua non*"; "*actus rea; mens rea; extrema ratio; ratio; ratio legis*"; "*nullum crimen, nulla poena sine culpa*"; "*fumus commissi delicti*

mënyrë korrekte gjuhën shqipe, si përsa i përket përdorimit të të gjitha shkronjave të alfabetit, përfshirë (ë dhe ç), si dhe ndërtimit të fjalive dhe paragrafëve në mënyrë korrekte nga ana gramatikore. Vlerësoj se në vendimet gjyqësore janë zbatuar me përpikmëri rregullat e gjuhës shqipe. Vendimet janë shkruar sipas rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Përsa i përket strukturës së vendimeve gjyqësore kam ndjekur një strukturë të qartë, të mirëorganizuar dhe përdorimit të një gjuhe të thjeshtë, të qartë dhe të kuptueshme, si nga pikëpamja e faktit ashtu edhe e ligjit, si për palët e përfshira në procesin gjyqësor, por edhe për publikun e gjerë. Lidhur me strukturën e vendimit gjyqësor në çdo rast kjo strukturë, organizimi i paragrafëve, identifikimi i fakteve konkrete, ligji të zbatueshëm, pretendimeve dhe prapësimeve të palëve, vlerësimit nga ana e gjykatës dhe përfundimit, kjo strukturë është përshtatur edhe në varësi të natyrës së çështjes, sikurse penale themeli, kërkesa penale hetimit paraprak, kërkesa penale në kuadër të seancës paraprake, si dhe kërkesa penale në fazën e ekzekutimit të vendimit.”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, në çdo nënndarje të saj, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” është “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.b Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit.

Organizimi i arsytimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kyçe të vendimit mund të humbasin, apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsytimit ligjore, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike, që juristës/ gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda

duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që duhet të zbatohet për zgjidhjen e saj, analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzionin e arritur.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuara me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë dhe në të gjitha rastet. Këto pjesë janë ndara në paragrafë, të cilat e lehtësojnë shumë të kuptuarit e vendimit duke mundësuar referimin në paragrafët e mësipërm. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit e çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data e shqyrtimit, palët (prokurori, i akuzuari dhe i dëmtuari), përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit (*akuza ose objekti i kërkesës penale*), baza ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur.

Pjesa përshkruese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë, të cilat janë të identifikuara me tituj, duke orientuar lexuesin për përmbajtjen e secilës pjesë të vendimit. Mënyra e organizimit të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimeve burim vlerësimin ndjek kryesisht këtë renditje:

rrethanat procedurale, duke u ndalur kryesisht në ecurinë procedurale të çështjes si dhe në aspekte që lidhen me të drejtat e palëve, njoftimin dhe pjesëmarrjen e tyre në gjykim, analizën dhe vlerësimin kryesisht të gjykatës lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës (vetëm në një rast, në vendimin nr. 339 (2346), datë 09.05.2019), etj. Në këtë pjesë, në vendimet penale të themelit, ndryshe nga ato të seancës paraprake, evidentohen edhe vendimmarrjet e ndërmjetme të gjykatës gjatë procesit si p.sh. në rastin e shqyrtimit të kërkesës për procedim me gjykim të shkurtuar në çështjet penale të themelit apo për zhvillimin e seancës paraprake në çështjet me objekt dërgim në gjyq etj.

- (i) *Rrethanat procedurale*¹⁵¹ është një nënpjesë nuk evidentohet në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi
- (ii) *Rrethanat e faktit dhe burimet e provave*¹⁵² të lejuara dhe administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra tjetrën, duke konkluduar për faktin e provuar si deduksion

¹⁵¹ Evidentohet vetëm tek vendimet me objekt dërgim i çështjes në gjyq

i analizës së provave. Faktet e çështjes analizohen në pjesën e dytë ose të parë të vendimit, duke integruar dhe analizuar provat e marra dhe duke u ndalur herë pas herë në vlerën provuese të tyre. Gjyqtari i kushton rendësi kësaj pjese të arsytimit të vendimit, duke i paraqitur faktet e çështjes përgjithësisht në mënyrë korrekte edhe koncize, herë të detajuar duke i dhënë qartësi faktit penal objekt gjykimi. Në rastet kur në vendime nuk rezulton nënpjesa “rrethanat procedurale”, këto të fundit përshkruhen në këtë nënpjesë.

(iii) Pretendimet e palëve. Kjo nënpjesë nuk evidentohet në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi. Në rastet kur evidentohet, në këtë nënpjesë përshkruhen në rend kronologjik veprimet paraprake të kryera nga gjyqtari që nga momenti që është paraqitur kërkesa nga prokuroria deri në seancën gjyqësore.

(iv) Vlerësimi i gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsytimi vijon me një nënndarje të titulluar “Vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqtari zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në disa rasteve në nënndarje, ku merren në analizë përgjegjësia penale për secilin të pandehur apo vepër për të cilën procedohet. Në këtë pjesë konstatohet se mendimi juridik është i ndarë në paragrafë, që të mundësojë një kuptim të qartë të analizës juridike. Në *vendimet penale të themelit* gjyqtari e ka organizuar këtë pjesë të vendimit duke analizuar fillimisht elementët e figurës së veprës penale për secilin të pandehur për të vijuar me pas me analizën ligjore në drejtim të caktimit dhe individualizimit të dënimit. Pjesë e analizës ligjore, në përmbajtje apo në përfundim të argumentimit të saj lidhur me zgjidhjen e çështjes, janë edhe pretendimet e palëve të cilat merren në analizë lidhur edhe me faktet e provuara apo edhe më vete. Në tërësi, gjyqtari organizon pjesën e arsytimit ligjor të vendimit duke shtjelluar dhe renditur fillimisht argumentet në mbështetje të konkluzionit dhe më pas jep konkluzionin e saj mbi bazueshmërinë ose jo të kërkesës penale. Analiza ligjore, në çështjet penale themeli, organizohet duke filluar me referimin e ligjit material të zbatueshëm, zberthimin dhe analizën e elementëve të figurës së veprës penale konkrete dhe përjasjen e tyre me faktin penal të provuar në gjykim, për të vijuar me konkluzionin mbi ekzistencën e veprës penale dhe fajësinë e të pandehurit dhe më tej, me analizën në një pjesë më vetë, lidhur me përcaktimin e llojit dhe të masës së dënimit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës mbi : (i) përgjegjësinë penale të të pandehurit mbi akuzën që i atribuohet (*deklarimin fajtor apo të pafajshëm*), (ii) mënyrën e disponimit në çështjet specifike të seancës paraprake (*dërgimin në gjyq apo pushimin e procedimit penal*), (iii) dënimin dhe masën e dënimit, (iv) llogaritjen e dënimit, (v) mënyrën e ekzekutimit të tij, (vi) shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu, në të gjitha vendimet objekt vlerësimi pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj. Në asnjë rast, nuk ka mospërputhje të arsytimit ligjor dhe dispozitivit.

¹⁵² Në disa raste vetëm me nëntitullin rrethanat e faktit/çështjes

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural penal, referuar natyrës së tyre ose kategorisë së çështjes, dhe konkretisht elementët e përcaktuar në nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale, në vendimet e seancës paraprake për dërgimin e çështjes në gjyq apo pushimin e procedimit penal dhe nenin 383 të K.Pr.Penale, në vendimet penale themelit, etj.

Siç u theksua më lartë, gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, kjo sikundër e cituam edhe më sipër, duke i ndarë vendimet në pjesë, ku gjyqtari zbaton rregullat e shkrimit ligjor, duke identifikuar faktet, provat, argumentin ligjor në lidhje me faktet, ligjin e zbatueshëm, analizën juridike dhe konkluzionin e arritur.

Megjithatë titujt e nëndarjeve të vendimit gjyqësor (*procedura, rrethanat e çështjes, ligji i zbatueshëm, vlerësimi/arsyetimi i gjykatës*) nuk janë të vetme mjete të majftueshme për organizimin e argumentit logjik. Janë paragrafët, të cilët gjyqtari i përdor shumë mirë, ata që e organizojnë shkrimin sipas ideve dhe lehtësojnë të kuptuarit e mendimit, duke e ndarë në njësi më të thjeshta, paragrafë të cilat duhen rënditur në atë mënyrë që mendimi të vijë rrjedhshëm, njëri pas tjetrit.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij në treguesin “*Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit*” në shkallë shumë të lartë. Ai shprehet se: “*Sikurse është shpjeguar edhe sa më sipër, vlerësoj se në çdo rast nga ana ime vendimi gjyqësor është hartuar duke ndjekur një strukturë të qartë, të mirëorganizuar, të ndarë në paragrafë, duke patur një lidhje logjike paragrafët me njëri tjetrin, si dhe lidhje logjike me përfundimet e arritura, për çdo pjesë përbërëse të vendimit gjyqësor*”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë pjesë e rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që për çdo nëndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit”, vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme dhe arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitivin e vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formuar. GJEDNJ është shprehur se, megjithëse gjykatave i lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa i përket strukturës dhe përmbajtjes, ato janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për tu ankuar¹⁵³.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se :

Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtari në raport me faktin penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjyqimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore apo ndarjen e çështjeve; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këtë fazë të procedimit; procedimit me gjykim të shkurtuar si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtat e të dëmtuarit në gjykim, etj.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, zhvillohet mbi bazën e një analize juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, duke bërë një analizë tërësore dhe koncize të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të qartë të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim. Përgjithësisht, konstatohet se gjyqtari i kushton rëndësi identifikimit dhe analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zberthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim në rastet konkrete në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes.

¹⁵³ Vendimi I GJEDNJ, Çështja Dadjanastassion vs Greqisë, datë 16.12.1992, faqe 33.

Arsyetimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse si dhe çështjeve të ngritura kryesisht për diskutim nga gjyqtari.

Në vendimet burim vlerësimi, gjyqtari paraqet dhe analizon faktet të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe merr në analizë elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me faktin penal. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtari integron në mënyrë të natyrshme faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural.

Gjyqtari ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake, apo në raport me faktin për të cilin kërkohet pushimi i procedimit penal. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, i shërben arsyetimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në mbështetje të konkluzioneve të saj për zgjidhjen e çështjes, kryesisht në drejtim të :

- (i) analizës së figurës konkrete të veprës penale për të cilën procedohet, zbërthimin dhe analizën e elementëve e saj si dhe autorësisë e të pandehurit¹⁵⁴,
- (ii) institutin procedural të gjykimit të shkurtuar, duke analizuar në çdo rast kushtet procedurale për pranimin e tij së bashku me analizën dhe vlerësimin mbi kushtet thelbësore që vlerësohen për procedimin me këtë rit të posaçëm gjykimi¹⁵⁵;
- (iii) institutin e amnistisë, duke u ndalur në konceptin dhe llojet e saj, si dhe pasojat përkatëse, duke evidentuar edhe jurisprudencën gjyqësore për këtë qëllim¹⁵⁶ ;
- (iv) institutin e parashkrimit të ndjekjes penale, duke u ndalur në kuptimin, qëllimin dhe afatet e disiplinuarat prej ligjvënësit¹⁵⁷ ;
- (v) institutin e lirit me kusht, duke analizuar kuptimin, qëllimin dhe benefitet e tij, duke sjellë në vëmendje edhe jurisprudencën përkatëse në lidhje me të¹⁵⁸
- (vi) analizës lidhur me kushtet dhe kriteret ligjore të përcaktimi dhe individualizimit të dënimit, analizës lidhur me rrethanat rënduese dhe lehtësuese që ndikojnë për përcaktimin e dënimit si dhe aplikimin në këtë drejtim të parimeve mbi të cilat caktohet dënimi penal

¹⁵⁴ Në të gjitha vendimet penale të themelit apo edhe ato të seancës paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq gjyqtari ndalet në analizën e elementëve të figurës së veprës penale dhe përfaqshjen e faktit të provuar në raport me to, në funksion të vlerësimit të saj mbi cilësimin juridik të faktit penal për të cilin procedohet.

¹⁵⁵ Në vendimet penale themeli.

¹⁵⁶ Vendimi nr. 115-456, datë 06.02.2017

¹⁵⁷ Vendimi nr. 450-1261, datë 19.03.2018; Vendimi nr. 383-1003, datë 06.03.2018; Vendimi nr. 1007-2567, datë 20.05.2019

¹⁵⁸ Vendimi nr. 339 (2346), datë 09.05.2019

në funksion të arritjes së qëllimit të tij. Po ashtu gjyqtari zhvillon analizën e kushteve ligjore të aplikimit të alternativave të dënimit me burgim duke u ndalur në analizën e qëllimit të aplikimit të tyre në raport me arritjen e qëllimit të dënimit penal apo zbatimin e parimit të caktimit të dënimit në mënyrë të drejtë dhe proporcionale¹⁵⁹;

(vii) analizën e figurës së gjyqtarit të seancës paraprake, rolin e tij me ndryshimet kushtetuese sipas ligjit 76/2016 dhe ndryshimet që ka sjellë ligji 35/2017, qëllimin e kësaj fazë të procedimit dhe elementet që janë objekt kontrolli nga gjykata me qëllim përgatitjen e çështjes për gjykim. Në kuadër të kësaj analizë gjyqtari ndalet dhe analizon dispozitat mbi pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave, mjaftueshmërinë e provave dhe ligjshmërinë e marrjes së tyre, para aplikimit të tyre mbi faktin konkret dhe vlerësimin përfundimtar mbi çështjen¹⁶⁰

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, në të gjitha vendimet burim vlerësimi rezultoi se ata janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi (me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo përcaktimin e natyrës së mosmarrëveshjes civile, etj.), duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar në përmbajtje të arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçuar të arsytimit (por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret). Pretendimet e palëve përgjithësisht kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

Në të gjitha vendimet penale gjyqtari ndjek të njëjtin rregull ku arritja e konkluzionit vjen pas analizës së ligjore të çështjes.

Gjyqtari e ka vlerësuar aftësinë e tij në drejtim të cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik në shkallë shumë të lartë. Ai shprehet se: *“Sikurse është shpjeguar edhe më sipër në rubrikat e tjera, në të gjitha vendimet gjyqësore është trajtuar në mënyrë të qartë marrëdhënia shkak – pasojë, në raport me rrethanat e faktit të analizuar në vendim, si dhe janë trajtuar parimet dhe institutet e së drejtës, në këndvështrim edhe të specifikave që paraqet çdo çështje dhe natyrës së saj. Vendimi gjyqësor në të gjithë strukturën e tij, me pjesët përbërëse e shpjeguar në rubrikat sa më sipër, ka një përmbajtje gjithëpërfshirëse, duke ju dhënë përgjigje të gjitha kërkesave dhe pretendimeve të palëve, të analizuar në raport me normën/normat ligjore të identifikuar dhe të zbatueshme. Konkretisht gjatë arsytimit, jam përpjekur që vendimin gjyqësor ta strukturoj me nënpika, duke i dhënë përgjigje në mënyrë të veçantë secilit prej pretendimeve të palëve. Kjo mënyrë strukturimi, përveçse i shërben qartësisë së vendimit gjyqësor, njëkohësisht e orienton palën në lidhje me përgjigjet për të gjitha pretendimet e tij. Në të gjitha vendimet normat ligjore të cituara me gjithë përmbajtjen e tyre, janë shoqëruar edhe me interpretimin dhe analizën përkatëse në raport me rrethanat e çështjes konkrete.*

¹⁵⁹ Në vendimet penale themeli në të cilat është disponuar me dënimin e të pandehurit

¹⁶⁰ Në të gjitha vendimet me objekt “Pushim i procedimit penal” dhe “Dërgim i çështjes në gjyq”

Gjithashtu në të gjitha vendimet gjyqësore, jam përpjekur të kryej një analizë cilësore, duke patur në konsideratë zhvillimin logjik të koncepteve ligjore. Gjithashtu, në arsyetimin e qëndrimit të gjykatës, për sa i përket pretendimeve të palëve, gjithmonë kam analizuar institutet juridike të zbatueshme në rastin konkret, si dhe kam interpretuar në mënyrë sistematike dhe logjike dispozitat ligjore të aplikueshme në raport me faktet e çështjes.

Dispozitivi i gjykatës, ka qenë gjithmonë deduksion i konkluzioneve të arritura në përfundimit të analizës logjike të fakteve të çështjes dhe ligjit të zbatueshëm. Në arritjen e këtij konkluzioni, përveçse referimit në përmbajtjen e vendimeve të gjykatës, kam në konsideratë edhe vendimmarrjen e gjykatave më të larta, të cilat në asnjë rast nuk kanë konstatuar mungesë apo paqartësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.”.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtari ka aftësi të larta në lidhje me treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentit logjik*”. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumenta të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur tek evidentimi i lidhjes shkak- pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për treguesin “*Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik*” vlerësohet “*Shumë e lartë*” dhe pikëzohet me 25 pikë.*

Niveli i vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
95	Shkëlqyeshëm

1. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË.

2.A.a Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 600 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 600 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 196 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 404 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (196 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (600 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar **32.7 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.**

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar treguesin “*Respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë, duke shpjeguar ndër të tjera se;” *Për të gjithë periudhën e vlerësimit, duhet të mbahet parasysh në pikëzimin e këtij kriteri, si një shkak komplementar i atyre të renditura më sipër, ngarkesa me çështje gjyqësore që unë si gjyqtar kam patur, e që sëbashku kanë ndikuar në tejkalimin e afateve ligjore. Mbajtur parasysh sa më sipër, vlerësoj se në të gjitha çështjet tejkalimi i afateve ligjore nuk ka qënë për neglizhencën time ose paaftësinë për të menaxhuar një proces gjyqësor dhe kërkoj që shpjegimet e mësipërme të mbahen parasysh në interpretimin e këtyre statistikave dhe pikëzimin e këtij kriteri.*

Sa më sipër në kushtet kur në asnjë rast tejkalimi i afateve nuk ka ardhur si pasojë e vullnetit tim apo mënyrës së organizimit të punës nga unë, si dhe për të gjitha arsyet e sipërcituara dhe ato që do gjeni në dokumentacionin bashkëlidhur formularit, vlerësoj se të gjitha çështjet duhet të konsiderohen si të gjykuara brenda afateve ligjore”

Në përlogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune për gjyqtarët apo 35 ditë kalendarike) ;
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve, 6 ditë ;

Kështu, referuar tabelave me të dhëna statistikore, rezulton si vijon:

- për vitin 2018
 - (i) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 2, 3, 10, 14, 27, 30, 151, 152, 153, 155 dhe 157 me objekt *“Dërgim çështje në gjyq”*¹⁶¹, është shortuar më datë 07.12.2017 dhe ka përfunduar me datë 15.01.2018, për 38 ditë ; shortuar më datë 11.12.2017 dhe ka përfunduar me datë 15.01.2018, për 34 ditë ; shortuar më datë 15.12.2017 dhe ka përfunduar me datë 17.01.2018, për 32 ditë ; shortuar më datë 15.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 22.01.2018, për 37 ditë ; shortuar me datë 05.01.2018 dhe ka përfunduar me datë 07.02.2018, për 32 ditë ; shortuar me datë 11.01.2018 dhe ka përfunduar me datë 13.02.2018, për 32 ditë ; shortuar më datë 12.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 17.09.2018, për 65 ditë ; shortuar më datë 19.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 18.09.2018, për 59 ditë ; shortuar më datë 19.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 18.09.2018, për 59 ditë ; shortuar më datë 16.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2018, për 63 ditë ; shortuar më datë 30.07.2018 dhe ka përfunduar me datë 24.09.2018, për 54 ditë. Nëse zbresim këtu periudhën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve apo lejen vjetore të muajit gusht rezulton se çështjet janë gjykuar për 32 ditë, 28 ditë, 26 ditë, 31 ditë, 32 ditë, 32 ditë, 30 ditë, 24 ditë, 24 ditë, 28 ditë dhe 19 ditë. Tejkalmimi me 1-2 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 30 ditor.**
- për vitin 2019
 - (i) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 4, 5, 26, 231, 232, 234, 235, 236, 237 dhe 238 me objekt *“ Dërgim çështje në gjyq”*, janë shortuar më datë 03.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 11.01.2019, për 38 ditë; shortuar më datë 03.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 11.01.2019, për 38 ditë ; shortuar më datë 27.12.2018 dhe ka përfunduar me datë 31.01.2019, për 34 ditë ; shortuar më datë 18.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 18.09.2019, për 60 ditë ; shortuar më datë 25.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2019, për 54 ditë ; shortuar më datë 15.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2019, për 64 ditë ; shortuar më datë 15.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2019, për 64 ditë ; shortuar më datë 15.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2019, për 64 ditë ; shortuar më datë 15.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2019, për 64 ditë ; shortuar më datë 15.07.2019 dhe ka përfunduar me datë 19.09.2019, për 64 ditë. Nëse zbresim këtu periudhën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve apo lejen vjetore të muajit gusht rezulton se çështjet janë gjykuar për 32 ditë, 32 ditë, 28 ditë, 25 ditë, 19 ditë, 29 ditë, 29 ditë, 29 ditë, 29 ditë dhe 29 ditë. Tejkalmimi me 2 ditë për disa nga çështjet do të konsiderohet i papërfillshëm e për pasojë çështjet do **të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor 30 ditor.**

¹⁶¹ Neni 332 i K. Pr. Penale ka parashikuar afatin ligjor të gjykimit 30 ditë.

Për pasojë, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme **21 çështjet e mësipërme do të konsiderohen si të përfunduara brenda afatit ligjor.**

Analiza e të dhënave statistikore nga ana e vlerësuesit duhet bërë në mënyrë të tillë që të shmangen përfundimet që vijnë për shkaqe që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Për analizën e këtij treguesi, vlerësuesi nuk bazohet vetëm në të dhënat statistikore, por merr në konsideratë të gjitha të dhënat dhe burimet e tjera të vlerësimit. Duke iu referuar tabelave me të dhënat statistikore si dhe çështjeve të analizuara më sipër, rezultoi se numri i çështjeve me afat ligjor është 600 çështje. Po ashtu në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (196 çështje), duhet të zbriten 21 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor. Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (175 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (600 çështje), rezulton të jetë 29%, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 9 pikë (21-30% -9 pikë).

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017-31.12.2019), 1669 çështje, nga të cilat 600 çështje parashikojnë afati ligjore gjykimi. Pra, 35.9% të numrit total të çështjeve kanë qenë me afat ligjor, përqindje e lartë duke e ngarkuar shumë gjyqtarin me çështje që kërkonin shpejtësi gjykimi. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 1184 çështje janë me palë kundërshtare.

Referuar standardit sasior në fuqi¹⁶², gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 100 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 300 çështje në tre vjet. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 1184 me palë kundërshtare, ose 395 çështje në vit nga 100 çështje që është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me thujse 3 herë.

Subjekti i vlerësimit e ka vlerësuar treguesin “*Respektimi i afateve ligjore*” në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “*Në lidhje me aftësitë organizative dhe përballimin e ngarkesës në punë për vitet 2017-2019, së pari dua të nënvizoj se kjo periudhë ka qenë me ngarkesë më të madhe përse i përket volumit të çështjeve, shtimit të llojeve të ndryshme të kërkesave me*

¹⁶² Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja a), parashikohet se “*Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 gjykime çështjesh penale (krime dhe kundravajtje)*”.

ndryshimet në Kodin e Procedurës Penale, ku u shtua figura e gjyqtarit të seancës paraprake, i cili duhet të shqyrtojë kërkesat me objekt dërgimin e çështjes për gjykim, si dhe kërkesat për pushim. Por edhe shtimi i gjykimeve të posaçme, sikurse miratimi i marrëveshjeve për pranimin e fajësisë dhe urdhrave penale kanë shtuar volumin e çështjeve për gjykim. Nga ana tjetër me hapjen e IEVP Shkodër në vitin 2018, gjithashtu kanë rritur ngarkesën në punë edhe kërkesat penale të paraqitura nga ana e të dënuarve në fazën e ekzekutimit të vendimeve, ku përfshihen kërkesa të llojeve të ndryshme, si përfitim nga amnisitia, përllogaritje paraburgimi, lirim para kohe me kusht, bashkim dënimesh, ulje dënimi etj. Të gjitha këto kategori të reja çështjesh përveç gjykimit të çështjeve të themelit, në raport edhe me mangësitë në numrin e gjyqtarëve në seksionin penal për këtë vit, kanë sjellë përballimin dhe menaxhimin e një ngarkese të madhe në punë.

Nga ana tjetër vlerësoj se përveç çështjeve sa më sipër, jam caktuar edhe pjesë e seksionit penal për të mitur, ku shqyrtoj edhe kërkesat penale në fazën e hetimit paraprak lidhur me të miturit në konflikt me ligjin, si dhe shqyrtimin e çështjeve penale të themelit ku përfshihen të miturit në konflikt me ligjin dhe rastin kur viktimat janë të mitura. Pra edhe natyra e këtyre çështjeve së bashku me delegimet edhe në Gjykatat e Rretheve të tjera Gjyqësore, sikurse Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pukë dhe në Gjykata të tjera, si Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, Tropojë, Kurbin kanë shtuar ngarkesën në punë.

Referuar statistikave të gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, rezulton se gjatë periudhës 2017-2019 kam gjykuar gjithësej 1,669 çështje të natyrave të ndryshme penale)ku vetëm në vitin 2019 kam përfunduar së gjykuari gjithësej 844 çështje penale). Ky numër e tejkalon disa herë standardin minimal vjetor të gjykimeve nga gjyqtari referuar vendimit orientues të KLD-së. Më konkretisht kam gjykuar gjithësej 556 çështje gjyqësore mesatarisht për të cilat ligji parashikon afat dhe vetëm disa prej tyre janë gjykuar jashtë këtij afati(sipas referencave të tabela statistikore 2017-2019 dhe analizës që kam bërë vetë në lidhje me to, i cili i bashklidhet këtij vetëvlerësimi zyrtarisht). Referuar statistikave rezulton e provuar se tejkalimi i afateve ka qenë në disa ditë dhe shumë rrallë në muaj...”

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të lartë për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore. Nëse në përllogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkalar me një kohë relativisht të shkurtër (1 deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 175 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (175 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (600 çështje), rezulton të jetë **29 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor**, përqindje që sipas Metodologjisë vlerësohet me 9 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 29 % (ii) ngarkesën e gjyqtarit si relator (në total për tre vite ka gjykuar

1681 çështje, nga të cilat 35.9 % apo 600 çështje janë me afat ligjor dhe 1184 me palë kundërshtare), faktin se ai e ka tejkaluar standardin sasior mesatare me thujtse 3 herë, (iii) faktin që shumë çështje e kanë kaluar afatin për shumë pak ditë, 3, 4, 5 ditë dhe (iv) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtar e trupave gjykues, kohën që gjyqtari kalon në zhvillimin e seancave, gjyqtari për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i afateve ligjore” është shumë e lartë, brenda marzhit “0-10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 1069 çështje për të cilat zbatohet standardi minimal kohor (242 çështje në vitin 2017, 265 çështje në vitin 2018 dhe 562 çështje në vitin 2019), të cilat i përkasin kategorive të çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Penale krime”, “Penale kundërvajtje” dhe “Seanca paraprake-kërkesa” për të cilat vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010, i KLD përcakton këto standarde minimale kohore për gjykimin në gjykatën e shkallës së parë, si vijon:

- jo më tej se 6 muaj (180 ditë) për gjykimet civile të themelit;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për gjykimet familjare;
- jo më tej se 9 muaj (270 ditë) për krimet me maksimumin e dënimit deri në 10 vjet dhe 12 muaj (365 ditë) për krimet me minimumin e dënimit jo më pak se 10 vjet;
- jo më tej se 4 muaj (120 ditë) për kundërvajtjet penale;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave civile pa palë kundërshtare;
- jo më tej se 2 muaj (60 ditë) për gjykimin e kërkesave administrativo-penale.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 1069 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 143 prej tyre ose **13.4 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.**

Në formularin e integruar të vlerësimit, referuar këtij treguesi, gjyqtari shprehet “Në ato çështje gjyqësore në të cilat është tejkaluar afati orientues, përveç arsyeve objektive të sqaruara në rubrikën e mësipërme, pezullimi i gjykimeve sipas nenit 352/1 të K.Pr.Penale është një tjetër shkak objektiv që ka ndikuar në mosrespektimin e afatit. Duhet theksuar fakti se në asnjë rast mosrespektimi i afatit nuk ka ndodhur për shkak të sjelljes sime si gjyqtar apo neglizhencës, apo për arsye jo objektive. Ai ka ndodhur për shkaqe të përligjura, të njohura si të tilla edhe nga GJEDNJ-ja, referuar standardeve që

ka vendosur në jurisprudencën e saj për sa i përket gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm.... Duke analizuar të gjithë faktorët sa më sipër, në raport me përfundimet e pasqyruara në analizën statistikore të gjykatës për gjykimin e çështjeve për vitin 2017-2019, raportin e numrit total të çështjeve të gjykuara në raport me numrin e çështjeve të përfunduara si relator jashtë afatit standart minimal kohor, vlerësoj se kam përmbushur në një nivel të arsyeshëm dhe shumë të lartë për plotësimin e standarteve minimale në gjykimin e çështjeve penale të llojeve të ndryshme...!

Lidhur me analizën logjike të të dhënave dhe përjashtimin e rrethanave që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, gjejnë mbështetje në Skemën e Vlerësimit të Gjyqtarëve, pasi:

Së pari, standardet minimale kohore nuk janë afate të arsyeshme. Ato nxisin gjyqtarin të jetë sa më produktiv, pavarësisht ngarkesës në punë. Standardet orientuese janë indikator matës i performancës së gjyqtarit. Ndërsa qëllimi i afateve të arsyeshme nuk është përcaktimi në mënyrë taksative i afateve të arsyeshme të gjyqimit të çështjeve për gjyqtarin në vetvete, por si afate maksimale për përfundimin e tyre, shkelja e të cilave legjitimon kërkuesin palë në proces që të kërkojë dëmshpërblim.

Së dyti, afatet e përcaktuara me vendimin nr. 261/2 të ish KLD-së për përfundimin e çështjeve (civile apo penale) kanë qenë dhe ende janë afate orientuese në funksion të menaxhimit dhe efikasitetit të çështjeve gjyqësore nga ana e gjyqtarit. Këto afate orientuese shërbejnë si një standard matës për efekt të vlerësimit të gjyqtarëve, nëse ata në punën e tyre kanë ndërmarrë një rol të vëmendshëm në planifikimin e seancave gjyqësore dhe në sigurimin e administrimit efikas të seancave gjyqësore, e për rrjedhojë të përfundimit të çështjeve në një kohë sa më të shkurtër. Nga ana tjetër, tejkalimi i këtyre afateve orientuese, nuk nënkupton shkeljen e standardit të procesit të rregullt ligjor parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 të KEDNJ-së

Së treti, afatet e nevojshme për kryerjen e veprimeve procedurale të detyrueshme për tu zbatuar (*njoftimi i deklaratës së mbrojtjes, njoftimi me shpallje për palët...etj.*), apo edhe ato opsionale për tu zbatuar (*shpallja e arsyetuar e vendimit, etj.*) llogariten në afatin standart orientues të gjyqimit të çështjes. Standardet orientuese përfshijnë në vetvete edhe kohën që i duhet gjyqtarit për kryerjen e veprimeve procedurale, të tilla si: shtyrjen deri në 20 ditë për shpallje të arsyetuar të vendimit; shtyrjen deri në tre ditë për tu shprehur në lidhje me kërkesat e palëve ; respektimin e afatit 30/ditor për paraqitjen e deklaratës së mbrojtjes ; afatit 20/ditor për njoftimin e palëve me shpallje, afati 5/ditor për paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim (neni 302/2 i K.Pr.Civile) etj.

Së katërti, afatet të cilat nuk janë në funksion të procesit (*si p.sh. afati 35 ditë ne muajin Gusht - leja vjetore*) apo afatet të cilat ecin për shkak të disa veprimeve procedurale (*si p.sh. koha e kaluar nga pezullimi i çështjes deri në rifillimin e saj, koha e kaluar nga data e ankimit të një vendimi të ndërmjetëm, faza e parë e pjesëtimit, ankim ndaj pezullimit të çështjes, parashtrimi i konfliktit të kompetencës Gjykatës së Lartë, etj.*), janë afate, të cilat nuk duhet të llogariten në afatin orientues, pasi ato nuk ecin jo për shkak të menaxhimit jo të mire të çështjes nga ana e gjykatës. Në këtë kontekst, këto afate nuk duhet të llogariten në

kohëzgjatjen e gjykimit, për aq sa rezultojnë të referuara nga ana e gjyqtarit për çështje konkrete apo nga të dhënat e pasqyruara në tabelat statistikore. Po kështu duhet mbajtur në vëmendje edhe caktimi i gjyqtarit si relatore e çështjes, në ato raste kur çështja është shortuar pas dhënies së dorëheqjes apo përjashtimit të gjyqtarëve të tjerë. Në rastin konkret nuk rezulton që gjyqtari të ketë referuar të dhëna për kohën e pezullimit, kthimit të çështjes për vijimin e hetimeve, etj., për çështje konkrete, duke pamundësuar identifikimin dhe analizën e këtyre çështjeve. Për pasojë, në rastin konkret, duke iu referuar tabelave me të dhëna statistikore, e vetmja e dhënë objektive që rezulton është kohëzgjatja e gjykimit dikuar nga leja vjetore në muajin gusht, e cila do të analizohet dhe zbritet në çështjet respektive.

Në përlogaritjen e standardit minimal kohor, për të gjitha dosjet, përlogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlogaritje do të zbriten:

- leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh (ligji parashikon 25 ditë pune apo 5 javë kalenderike për gjyqtarët);
- festat e fundvitit dhe afati i mbartjes së dosjeve 6 ditë ;

Duke mbajtur në konsideratë analizën e sipërcituar, vlerësohet që të konsiderohen si çështje të cilat kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor çështjet si më poshtë:

- për vitin 2017
 - (i) në tabelën nr. 1, çështjet civile me palë kundërshtare me nr. rendor 10 dhe 12, janë gjykuar për 6 muaj e 7 ditë dhe 6 muaj e 6 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve, rezulton që çështjet janë gjykuar për 6 muaj e 1 ditë dhe 6 muaj. Tejkalimi i afatit me 1 ditë për një të çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
 - (ii) Në tabelën nr. 2, çështja civile pa palë kundërshtare me nr. rendor 15 është gjykuar për 2 muaj e 4 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja është gjykuar për 1 muaj e 28 ditë **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
 - (iii) Në tabelën nr. 8, çështjet penale që dënohen deri në 10 vjet burgim, çështja me nr. rendor 54 dhe 127 janë gjykuar për 9 muaj e 17 ditë dhe 9 muaj e 11 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 8 muaj e 12 ditë dhe 8 muaj e 6 ditë, **brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj (270 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
 - (iv) Në tabelën me nr. 9, çështja penale kundravajtje me nr. rendor 27, është gjykuar për 4 muaj e 9 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton se çështja është gjykuar për 3 muaj e 4 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**
 - (v) Në tabelën nr. 12, çështjet kërkesa penale me nr. rendor 2, 6, 12 dhe 15 janë gjykuar për 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 3 muaj e 3 ditë dhe 2 muaj e 4 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së

dosjeve (nr.2) si dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht (nr.12), rezulton se çështjet janë gjykuar për 1 muaj e 29 ditë, 2 muaj e 5 ditë, 1 muaj e 28 ditë dhe 2 muaj e 4 ditë. Tejkalmi i afatit deri me 5 dite do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

- për vitin 2018

(vi) në tabelën nr. 1, çështja civile me palë kundërshtare me nr. rendor 2, është gjykuar për 6 muaj e 20 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton që çështja është gjykuar për 5 muaj e 15 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj (180 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(vii) Në tabelën nr. 8, çështjet penale që dënohen deri në 10 vjet burgim, çështja me nr. rendor 59 është gjykuar për 9 muaj e 20. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve si dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton se çështja është gjykuar për 8 muaj e 9 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj (270 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(viii) në tabelën nr. 9, çështjet kundravajtje penale me nr. rendor 22 dhe 25 janë gjykuar për 4 muaj e 8 ditë dhe 5 muaj e 8 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjes lejen vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 3 muaj e 3 ditë dhe 4 muaj e 3 ditë. Tejkalmi i afatit me 3 dite për një të çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 4 muaj (120 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(ix) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 149, 165, 167, 179 dhe 180, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj 15 ditë, 2 muaj 17 ditë, 2 muaj 12 ditë, 2 muaj 28 ditë dhe 2 muaj 29 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve lejen vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 1 muaj e 10 ditë, 1 muaj e 12 ditë, 1 muaj e 7 ditë, 1 muaj e 23 ditë dhe 1 muaj e 24 ditë, pra **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

- për vitin 2019

(i) Në tabelën nr. 8, çështjet penale që dënohen deri në 10 vjet burgim, çështja me nr. rendor 78 është gjykuar për 10 muaj e 13 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve si dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezulton se çështja është gjykuar për 9 muaj e 2 ditë. Tejkalmi i afatit me 2 dite do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështja do të konsiderohet e gjykuar **brenda standardit minimal kohor prej 9 muaj (270 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(ii) në tabelën nr. 11, çështjet me nr. rendor 3, 83, 176 dhe 250, të cilat janë gjykuar përkatësisht në afatin 2 muaj 3 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 2 ditë dhe 2 muaj 19 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve si dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, çështjet rezultojnë të gjykuara për 1 muaj e 27 ditë, 2 muaj e 1 ditë, 2 muaj e 2 ditë dhe 1 muaj e 14 ditë Tejkalmi i afatit me 2 ditë për një të çështje do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

(iii) Në tabelën nr. 12, çështjet kërkesa penale me nr. rendor 19, 27, 46, 138, 154, 162, 163, 177, 180, 182, 187, 189, 190, 191, 192, 193, 196, 197, 199, 208 dhe 222 janë gjykuar për 2 muaj e 6 ditë, 2 muaj e 11 ditë, 2 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 3 muaj e 4 ditë, 2 muaj e 29 ditë, 2 muaj e 24 ditë, 2 muaj e 13 ditë, 3 muaj e 13 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 22 ditë, 2 muaj e 3 ditë, 2 muaj e 3 ditë, 3 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 8 ditë, 2 muaj e 29 ditë, 2 muaj e 3 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë. Duke mos përfshirë në kohëzgjatjen e çështjeve kohën e festave të fundvitit dhe mbartjes së dosjeve si dhe kohën e pushimeve vjetore të muajit gusht, rezultojnë se çështjet janë gjykuar për 2 muaj, 2 muaj e 5 ditë, 2 muaj e 2 ditë, 2 muaj e 6 ditë, 1 muaj e 29 ditë, 1 muaj e 24 ditë, 1 muaj e 19 ditë, 1 muaj e 7 ditë, 2 muaj e 7 ditë, 1 muaj e 3 ditë, 1 muaj e 2 ditë, 1 muaj e 2 ditë, 1 muaj e 2 ditë, 1 muaj e 17 ditë, 29 ditë, 29 ditë, 1 muaj e 27 ditë, 1 muaj e 3 ditë, 1 muaj e 24 ditë, 2 muaj e 3 ditë dhe 2 muaj e 3 ditë. Tejkalmimi i afatit deri me 7 ditë do të konsiderohet i papërfillshëm dhe çështjet do të konsiderohen të gjykuara **brenda standardit minimal kohor prej 2 muaj (60 ditë) sipas vendimit 261/2 të ish KLD-së.**

Pra, janë gjithsej 45 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 143 çështjesh të përlllogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 98 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 1069 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, e cila nuk është më 143, por rezultojnë të jetë 98 çështje, ose 9.1% e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Sipas “*Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit*”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 9.1 % përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

Gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në shkallë shumë të lartë duke u shprehur se: “*Në ato çështje gjyqësore në të cilat është tejkalmuar afati orientues, përveç arsyeve objektive të sqaruara në rubrikën e mësipërme, pezullimi i gjykimeve sipas nenit 352/1 të K.Pr.Penale është një tjetër shkak objektiv që ka ndikuar në mosrespektimin e afatit. Duhet theksuar fakti se në asnjë rast mosrespektimi i afatit nuk ka ndodhur për shkak të sjelljes sime si gjyqtar apo neglizhencës, apo për arsye jo objektive. Ai ka ndodhur për shkaqe të përlligjura, të njohura si të tilla edhe nga GJEDNJ-ja, referuar standardeve që ka vendosur në jurisprudencën e saj për sa i përket gjyqimit brenda një afati të arsyeshëm.*

Gjithashtu vlerësoj të nënvizoj përveç ngarkesës në punë, shtimit të llojeve të çështjeve, delegimeve në gjykata të tjera, edhe faktorë të tjerë, të cilët sjellin si pasojë një numër më të madh të zhvillimit të seancave gjyqësore, shtyrje të tyre e për pasojë tejkalmimin e afateve minimale, sipas specifikave të listuara si më poshtë vijon:

- *Ngarkesa shumë e madhe e seksionit penal ku unë kam bërë pjesë sidomos në vitin 2019 ku kampërfunduar së gjykuarit 844 çështje në një seksion të përbërë nga katër gjyqtar penalist, ku nuk janë pasqyruar as edhe në tabela çështjet ku unë kam qenë anëtar i trupit*

grykues, të cilat ka qenë në numër të konsiderueshëm. Gjithashtu delegimet në gjykatat e tjera me vendim të KLGJ-së.

- Në çështjet penale paraprake (pushimet e procedimeve) dhe ato të themelit, një problematikë paraqet njoftimi i të pandehurit/pandehurve, kur janë më shumë se një, ku në shumicën e rasteve njoftimet nuk vijnë të plota për shkak të mosgjetyes në adresat e deklaruar ose pasaktësisë së tyre, ç'ka sjell përsëritjen e tyre, jo vetëm nëpërmjet fletëthirrjeve, por edhe nëpërmjet shërbimeve të policisë gjyqësore të Komisariateve respektive që mbulojnë vendbanimet e tyre, si dhe administrimi në kuadër të kërkimeve të plota edhe informacionit nga sistemi TIMS, lidhur me hyrjet dhe daljet e tyre nga Republika e Shqipërisë. Në shumicën e rasteve këto përgjigje lidhur me kërkimin e të pandehurve (sidomos në rastet kur duhet njoftuar më shumë se një i pandehur), nuk vijnë në afatin/seancën gjyqësore të planifikuar, sjell si pasojë shtyrjen e seancave gjyqësore...”*

KONKLuzioni

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (98 çështje) me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi (1069 çështje) që rezulton 9.1 % ; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm me rreth 3 herë, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” vlerësohet se gjyqtari duhet të pikëzohet me 5 pikë, pasi shqyrtimi i 9.1 % të çështjeve jashtë standardit minimal kohor është brenda normës së vlerësimit me 5 pikë të përcaktuara nga metodologjia.*

2.A.c Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, krahasuar me standardin minimal kohor në fuqi sipas vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, për secilën kategori, pa përfshirë çështjet për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, është si më poshtë:

- i. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 458 ditë, pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 6 muaj (180 ditë);*

- ii. Në kategorinë e çështjeve “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 23 ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- iii. Në kategorinë e çështjeve “Penale-krime”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 85 ditë (2 muaj e 25 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 9 apo 12 muaj;
- iv. Në kategorinë e çështjeve “Penale-kundërvajtje”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 70 ditë (2 muaj e 10 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 4 muaj;
- v. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 69 ditë (2 muaj e 9 ditë), pra **më e gjatë** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- vi. Në kategorinë e çështjeve “Seancë paraprake”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 35 (1 muaj e 5 ditë) ditë, pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj;
- vii. Në kategorinë e çështjeve “Kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridikionale me jashtë”, koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është 45 ditë (1 muaj e 15 ditë), pra **më e shkurtër** se standardi minimal kohor i miratuar, prej 2 muaj.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari, e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mbi mesatar duke theksuar se: *“E vlerësoj shumë të lartë aftësinë time për të përfunduar çështje në afat, sipas kategorisë përkatëse në raport me standardet minimale të kërkuara për çdo kategori. Jam përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e parashikuara si standarde minimale kohore, sipas kategorive, por gjithmonë duke u kujdesur që kjo të mos çënojë të drejtat e palëve në proces, kontradiktoritetin, mbrojtjen efektive, garantimin e hetimit të plotë dhe të gjithanshëm për zgjidhjen e drejtë të çështjes, cilësinë e gjykimit dhe të drejtën për proces të rregullt ligjor.*

Në lidhje me këtë kriter vlerësoj se duke i'u referuar të dhënave statistikore rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve me përjashtim të kategorive të çështjeve “Dërgim në gjykim” dhe atyre në fazën e ekzekutimit përkatësisht ato që lidhen me IEVP-të.

Duke parashtruar sa më sipër vlerësoj të theksoj se shtyrjet e seancave kanë qenë për shkaqe të arsyeshme dhe në funksion të zgjidhjes në themel të tyre dhe për këtë tregues duhet të kem një vlerësim maksimal.....”

Referuar të dhënave statistikore, rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e shkurtër se standardi për shumicën e kategoritë e çështjeve, pasi nga 7 kategori çështjesh, standardi minimal është tejkaluar vetëm për njërin prej tyre, konkretisht për kategorinë “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”. Referuar metodologjisë së Pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me një pikëzim prej 4 pikësh.

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.¹⁶³

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi (01.01.2017-31.12.2019), 1681 çështje, nga të cilat 600 çështje janë me afat ligjor dhe 1184 me palë kundërshtare. Referuar standardit sasior në fuqi¹⁶⁴, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 100 çështje me palë kundërshtare në vit. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 395 çështje me palë kundërshtare në vit, nga 100 çështje që është e përcaktuar në Vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me 295 çështje apo me rreth 295 %.

KONKLUZIONI

Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (6 nga 7 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “Civile me palë kundërshtare”, pasur parasysh numrin shumë të lartë të çështjeve të gjykuara nga gjyqtari për periudhën tre vjeçare të vlerësimit (1681 çështje, nga të cilat 1184 çështje janë me palë kundërshtare), duke e tejkaluar disa herë standardin minimal sasior të përcaktuar me Vendimi nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” vlerësohet se duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e i barabartë me gjyqtari pikëzohet me 5 pikë.

2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

¹⁶³ Metodologjia e Pikëzimit për këtë tregues parashikon se : “...Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekteve të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal”.

¹⁶⁴ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja g), parashikohet se “Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, si relator, jo më pak se 200 gjykime çështje, penale (krime dhe kundravajtje) dhe civile që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje mes palëve kundërshtare”.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1669 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1686 çështje) brenda periudhës 3/vjeçare të vlerësimit, **është 98.8 %** përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 8 pikë, duke qenë se rezulton mbi 93-99% .

E ndarë në vite, rendimenti rezulton si më poshtë;

Për vitin 2017 i janë caktuar 364 çështje dhe ka përfunduar 384 çështje, pra 105.4 %;

Për vitin 2018 i janë caktuar 496 çështje dhe ka përfunduar 441 çështje, pra 88.9 %

Për vitin 2019 i janë caktuar 826 çështje dhe ka përfunduar 844 çështje, pra 102.1 %.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mesatar. Ndër të tjera gjyqtari thekson: “Ky vetëvlerësim është argumentuar si vijon: *“Për këtë rubrikë përsëri vlerësoj se kam aftësi shumë të larta mbi mesataren (1669/1686 x100%=98.9%), pasi jam përpjekur maksimalisht të respektoj afatet e gjykimit dhe kushtoj çështjeve kohën e duhur, pavarësisht se kompleksiteti tyre, ngarkesa e gjykatës, modalitetet, apo problemet me njoftimet, sjellja e palëve, apo arsye objektive të ndryshme mund të kenë çuar në zgjatjen e afatit.*

Mendoj që kam aftësi shumë të lartë në përfundimin në kohë të çështjeve gjyqësore. Njëkohësisht risqaroj se në periudhën e vlerësimit ka pasur një sërë shkaqesh të konsiderueshme që kanë bërë të pamundur respektimin e afateve (sqaruar në mënyrë më të detajuar në pjesën e formularit që trajton respektimin e afateve ligjore, si dhe dokumentacionin bashkëlidur formularit). Pavarësisht sa më sipër, kalimi i afateve ka qenë në përgjithësi disa ditë dhe ndonjëherë muaj, tejkalim i cili për sa më sipër relatuar nga ana ime, nuk duhet të merret në konsideratë nga ana Juaj. Në të gjitha vendimet e caktimit të seancave gjyqësore apo në shtyrjet e tyre, në vendimin e caktimit apo në procesverbale gjyqësore janë relatuar shkaqet e arsyes së caktimit të seancës në datën respektive. Kam zgjedhur planifikimin e seancave efektive dhe jo të atyre fiktive e të parealizueshme fakt i cili rezulton nga statistikat e mija nga të cilat rezulton që përgjithësisht çështjet janë zgjidhur brenda pak seancave.....”.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtari ka përfunduar në periudhën 3 vjeçare të vlerësimit ne total 1669 çështje nga të cilat 1184 çështje me palë kundërshtare (civile të përgjithshme, penale krime, penale kundërvajtje dhe kërkesa për pushim procedimi).

Referuar standardit sasior në fuqi¹⁶⁵, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 100 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 300 çështje në tre vjet. Gjyqtari e ka kaluar standardin minimal sasior me 884 çështje, apo me 295 %.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 98.8 %, por ndërkohë rezulton se (i) ai ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 294 %, (ii) ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh me palë kundërshtare (1184 çështje) dhe 485 çështje pa palë kundërshtare, nga të cilat 600 çështje kanë qenë me afat ligjor, vlerësohet se, në analizë logjike të të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë përqindjen e çështjeve të shqyrtuar tej standardit minimal sasior dhe ngarkesën totale në punë, gjyqtari duhet të vlerësohet dhe pikëzohet maksimalisht.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues vlerësohet me një nivel më të lartë pikëzimi se ai që përkon me rendimentin në masën 98.8% dhe pikëzohet me 10 pikë.

2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh është si më poshtë:

- i. Për të gjitha çështjet e kategorisë “*civile të përgjithshme me palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 11 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- ii. Për çështje të kategorisë “*civile të përgjithshme pa palë kundërshtare*”, koha mesatare e arsyetimit është 2 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 20 ditë i parashikuar nga neni 308/2 i K. Pr. Civile.
- iii. Për çështje të kategorisë “*krime*”, koha mesatare e arsyetimit është 18 ditë, **pra më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- iv. Për çështje të kategorisë “*kundravajtje*”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është 16 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- v. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:

¹⁶⁵ Në vendimin nr. 261/2, viti 2010, të ish KLD-së, lidhur me standardin sasior, në pikën 3, shkronja a), parashikohet se “Gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë i dhomës penale, si relator, jo më pak se 100 çështje penale (krime dhe kundërvajtje).”.

- Për kërkesa me objekt vleftësim arresti/ndalimi dhe caktim mase sigurimi, 1 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 të K. Pr. Penale.
 - Për kërkesa me objekt caktim mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është 1 ditë, pra **më e gjatë** se afati procedural i parashikuar nga neni 244/1 i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsytuar.
 - Për kërkesa me objekt verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit, përfaërsisht 1.5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 248 i K. Pr. Penale.
 - Për kërkesa me objekt zëvendësim/revokim mase sigurimi, 1,5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar për efekt të së drejtës së ankimit, referuar nenit 249 i K. Pr. Penale.
 - Për kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, 1,6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 48 orë i parashikuar nga neni 261/3 dhe 248/2 i K. Penal.
 - Për kërkesa me objekt lejim përgjimi/zgjatje afat përgjimi, 1 ditë, pra **sa afati** procedural 24 orë i parashikuar nga neni 222 i K. Pr. Penale.
 - Për kërkesa me objekt lejim kontrolli, 1 ditë, pra më e **gjatë** se afati procedural i parashikuar nga neni 202/a i K. Pr. Penale, i cili kërkon që vendimi të jepet i arsytuar.
 - Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural i përgjithshëm 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- vi. Për çështje të kategorisë “*seancë paraprake*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
- Për çështje me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, 6 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 10 ditë i parashikuar nga neni 332/dh i K. Pr. Penale.
 - Për çështje për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 25 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.
- vii. Për çështje të kategorisë “*kërkesa penale të fazës së ekzekutimit dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë*” koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar të subjektit të vlerësimit është:
- Për kërkesa me objekt shtyrjen e ekzekutimit të vendimit, koha mesatare e arsytimit është 1,5 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 5 ditë i parashikuar nga neni 476 i K. Pr. Penale.
 - Për kërkesa me objekt për të cilat ligji procedural nuk ka parashikuar afat për arsytimin e vendimit, 17 ditë, pra **më e shkurtër** se afati procedural 30 ditë i parashikuar nga neni 382 i K. Pr. Penale.

Nga 8 (tetë) nënkategoritë e kategorisë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*”, vetëm në 2 prej tyre, koha mesatare e arsytimit e ka tejkaluar afatin procedural, konkretisht tek çështjet me objekt “*Caktim mase*” dhe “*lejim kontrolli*”, për të cilat ligji parashikon se jepen të arsytuara. Ato rezultojnë të jenë dorëzuar në sekretarinë e gjykatës ditën tjetër, e

kjo normalisht ka ndodhur për shkak të veprimeve të kryera nga sekretarja gjyqësore për dorëzimin e dosjes si dhe rregullave të administrimit gjykatës.

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 15 pikë.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, duke shpjeguar se;” *Duke iu referuar treguesit mesatar të kohës së arsytimit për të gjitha vendimet gjyqësore të dhëna gjatë periudhës së vlerësimit, vlerësoj se gëzoj aftësi shumë të lartë për të arsytuar në kohë sa më të shpejtë vendimet gjyqësore.*

Përsa i përket respektimit të afateve procedurale në dorëzimin e vendimeve gjyqësore, duke u bazuar në të dhënat statistikore të nxjerra nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, vlerësoj se pavarësisht ngarkesës së madhe dhe volumit të madh të çështjeve të gjykuara për vitet 2017- 2019, nga ana ime është respektuar afati procedural i arsytimit dhe dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Ky arsyetim dhe dorëzim është realizuar duke respektuar afatet ligjore procedurale për secilën kategori çështjesh të parashikuar nga Kodi i Procedurës Penale.

Në vijim sa më sipër vlerësoj se është respektuar ky afat 100%, duke dorëzuar të gjitha dosjet në respektim të afateve procedurale, përkatësisht për çështjet e themelit, me të pandehur në gjëndje të lirë, gjykimet me marrëveshje, kërkesat për pushime dhe kërkesat e tjera penale në fazë ekzekutimi është respektuar afati maksimal procedural 30 ditor. Përsa u përket çështjeve penale të themlit me të pandehur me masë sigurimi personal “ arrest në burg” apo “ arrest në shtëpi”, është respektuar afati 15 ditor i dorëzimit të vendimeve gjyqësore. Gjithashtu përsa u përket kërkesave penale në seancë paraprake me objekt “ dërgimin e çështjes për gjykim”, është respektuar afati maksimal i parashikuar nga ligji 10- ditor. Theksoj se edhe në ato pak raste ku, sikurse rezulton nga statistikat ndonjë vonesë me 1 ose dy ditë, kjo vjen për arsye se afati i dorëzimit ka përfunduar ditë pushimi, e shtunë ose e dielë apo ditë feste zyrtare dhe dorëzimi është bërë në ditën pasardhëse të punës.

Nisur nga sa më sipër, vlerësoj se rendimenti ka qenë maksimal, përtej ngarkesës së madhe në punë dhe kohës që i duhet sekretares gjyqësore, përtej detyrave të tjera, në përgatitjen e dosjes, së bashku me të gjitha aktet, përfshirë edhe vendimin përfundimtar, deri në regjistrimin e saj në librat përkatës....”.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar klasifikohet si “*Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve*” dhe gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” vlerësohet se koha mesatare e arsytimit të vendimit është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, e për këtë arsye gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.B AFTËSIA PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE.

2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se në tabelat me të dhëna statistikore nuk rezultojnë të dhëna për numrin e seancave gjyqësore për të gjitha çështjet që gjyqtari ka përfunduar në periudhën e vlerësimit 2017-2019. Për pasojë, të dhënat për vlerësimin e këtij treguesi i referohen numrit të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim. Referuar të dhënave të analizuara në Raportin analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përfshiruar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë e çështjeve “*Penale themeli*”, është 2.8 (dy presje tetëdhjetë) seanca gjyqësore.
- (ii) për kategorinë e çështjeve/kërkesave “*Seanca paraprake*”, “*dërgim çështje në gjyq*”, “*pushim procedimi penal*” apo “*Kundërshtimin e vendimit të prokurorisë për pushimin e procedimit penal*” është 3.2 (tre presje njëzet) seanca gjyqësore.

Në kategorinë “*Penale themeli*” në 6 çështje janë zhvilluar 17 seanca gjyqësore; në kategorinë “*Seanca paraprake*”, në 12 çështje janë zhvilluar 39 seanca Pra, në total për 18 gjykime janë zhvilluar 56 seanca gjyqësore.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se numri mesatar i seancave gjyqësore, për të gjitha çështjet me palë kundërshtare, rezulton të jetë **3.1 seanca gjyqësore**.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari ka kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Konstatohet nga aktet në dosjet burim vlerësimi se gjyqtari për çdo çështje ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore dhe duke urdhëruar kryerjen e njoftimeve për palët dhe marrjen e masave për të siguruar prezencën apo shoqërimin e të pandehurve.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: shtyrë me qëllim njoftimin e palëve; me qëllim përsëritjen e njoftimeve për të pandehurit, duke qënë se nuk konfirmohet dijenia; me qëllim paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare; në kushtet e mosparaqitjes së gjyqtarit për shkak të qënies me leje; për shkak të mosparaqitjes së prokurorit, si dhe mbrojtësit të të pandehurve duke qënë se ndodhej në një tjetër gjykim; për shkak të mosnjoftimit të mbrojtësit; në bazë të kërkesës së prokurorit për të paraqitur gjithë fashikullin; për t'i dhënë mundësi ankuesit të njihet me fashikullin; me qëllim paraqitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim.

Pra, në tërësi, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qënë për shkaqe objektive, të pavarura nga veprimet e gjyqtarit së çështjes, si dhe për të kryer veprimet e nevojshme procedurale me qëllim zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtave procedurale të palëve dhe pjesëmarrësve në gjykim.

Caktimi i seancës së parë gjyqësore në ato raste kur parashikohet një detyrim ligjor për t'u respektuar (si afat maksimal), rezulton që gjyqtari nuk e ka respektuar afatin gjithmonë. Sipas raportit analitik, në çështjet e kategorisë seancë paraprake, referuar vendimit për kalimin e çështjes për shqyrtim, rezulton që gjyqtari ka caktuar datën e seancës së parë gjyqësore jashtë afatit ligjor 10 ditor të parashikuar në dispozitë neni 332/2 i K.Pr.Penale, por brenda 15 apo 20 ditësh. Vetëm në një rast¹⁶⁶ ky afat është zgjatur mbi një muaj për shkak të lejes vjetore në muajin gusht. Përgjithësisht, rezulton se seancat gjyqësore janë shtyrë brenda një afati deri në 14 ditë, konform nenit 342/2 të K.Pr.Penale. Vetëm në raste të rralla konstatohet lënia në një kohë të gjatë e seancës për shkak të festave në fund të vitit, periudhë që përkon me procedurën e mbartjeve të dosjeve nga administrata.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtari ka parashtruar se: *“Referuar orientimeve të dhëna në shpjegimin e mësipërm, vlerësoj se aftësia e planifikimit të seancave gjyqësore dhe shmangia e seancave jo produktive, është e lartë, referuar edhe afateve të përfundimit të gjykimit të analizuara më sipër, si dhe përbindjes së vogël të çështjeve gjyqësore të gjykuara jashtë afatit ligjor apo atij orientues. Në shumicën e çështjeve gjyqësore të shqyrtuara, janë planifikuar 1-3 seanca gjyqësore. Nga ana tjetër, në çështjet gjyqësore për të cilat janë*

¹⁶⁶ Vendimi nr. 1489-4269, datë 18.09.2018

planifikuar më shumë se tre seanca, duhet theksuar se shkaku kryesor ka qenë mosnjohimi efektiv i palëve, kërkesa për shtyrje të paraqitura nga palët të cilat kanë rezultuar të justifikuar, kompleksitetit të çështjeve, vonesave të krijuara nga shërbimi postar apo shërbimet e policisë gjyqësore etj. Nga ana tjetër, përgjithësisht tejkalimi i numrit minimal të seancave gjyqësore, është diktuar edhe nga nevoja e ndjekjes së të gjitha hapave të njohimit sipas parashikimit të dispozitave procedurale, të cilat qëndrojnë edhe në themel të respektimit të procesit të rregullt gjyqësor. Gjithashtu, si shkak i tejkalimit të numrit minimal të seancave në gjykimet penale ka shërbyer edhe ndjekja e ritit të gjykimet të zakonshëm, ku është proceduar me pyetjen e dëshmitarëve, realizimin e akteve të ekspertimit, marrja e provave të ndryshme etj.

Në të gjitha rastet e shtyrjes së seancave gjyqësore, kam marrë masa efektive që të shmang dështimin e seancës së rradhës, duke urdhëruar të kryhen njohimet në një kohë sa më të shpejtë, duke dërguar shkresa në institucionet përgjegjëse, duke marrë masa administrative për mbrojtësit apo ekspertët që kanë shtyrë seancat pa shkaqe të arsyeshme etj. Kam studiuar çështjet në një kohë sa më të shkurtër, duke punuar edhe jashtë orarit zyrtar.

Kam kryer veprime të nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo-produktive si: kalendari seancave, mbikqyrja e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njohimit dhe përsëritja e tyre përpara seancës në rast të mosrealizimit; marrja e masave për të siguruar njohime të rregullta për seancat pasardhëse duke bërë shënimet përkatëse në fletë-thirrje apo njohim paralelisht me mënyra të tjera si telefon/adresë elektronike etj)...”.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është shumë e lartë, duke u pikëzuar me 15 pikë.

KONKLUZIONI

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 3.1 seanca, gjyqtari në çdo rast ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive, për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave, shkalla e aftësisë duhet të vlerësohet si shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në lidhje me treguesin “Numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës gjyqësore pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht, konstatohet se gjithmonë gjykata ka vënë dosjen në lëvizje sikundër parashikohet në nenin 332 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, ndërkohë në çështjet penale të themelit në respektim të nenit 333/1 të K.Pr.Penale.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por duke treguar edhe kujdesin maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Gjyqtari ka marrë masat e nevojshme që të pranishëm në gjykimin të jenë jo vetëm i akuzuari dhe prokurori, por edhe i dëmtuari. Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë (*nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale*) apo sipas ritit të gjykimit të zhvilluar (*nenit 405 e vijues të K.Pr.Penale në rastin e gjykimit të shkurtuar*), apo sipas ritit të gjykimeve të seancave paraprake (*neni 332/c i K.Pr.Penale i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017*).

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo pa prezencën e viktimës apo kallëzuesit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj*). Drejtimi i seancës zhvillohet nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu rezulton që gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe

vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht për pranimin e kërkesës për të proceduar me gjykim të shkurtuar, caktimin e mbrojtësit etj.

Në dosje të vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me një vonesë më pak se 15 minuta, por edhe në rastet kur kjo vonesë ka qenë më shumë se 15 min rezulton që të jetë relatuar shkak nga ana e gjyqtarit në lidhje me shkaqet e fillimit të seancave me vonesë, kryesisht për shkak të gjykimeve të mëparshme. Pavarësisht kësaj, nuk ka rezultuar në asnjë rast që vonesa të jetë bërë shkak për moszhvillimin e seancës gjyqësore.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore. Vetëm në ndonjë rast të rrallë seanca është dokumentuar përmes procesverbalit me shkrim në mënyrë të përmbledhur, në pamundësi të sallave të lira të pajisura me sistem regjistrimi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari dhe kryetari e kanë vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtari ka parashtruar se: *“Vlerësoj se gëzoj aftësi shumë të lartë për të qënë efektiv në kryerjen e veprimeve procedurale të tilla si: Vënia në lëvizje e dosjes në kohë dhe në përputhje me afatet ligjore; kryerja e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh caktimin e afateve për të metat e padisë, njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes; planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive; dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale; drejtimi i një procesi të rregullt gjyqësor, duke orientuar drejt debatin mes palëve, duke u shprehur qartë, me urdhra dhe vendime të ndërmjetme për çdo kërkesëtë tyre; fillimi i seancave pa vonesë; regjistrimi audio i seancave; ndjekja me rigorozitet e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor; Seancat gjyqësore përgjithësisht kanë filluar në afat, duke llogaritur edhe kohën e thirrjes së palëve dhe shoqërimit të tyre në sallën e gjyqimit. Ato seanca të cilat kanë filluar me vonesë, përgjithësisht nuk i kanë kaluar 15 min, dhe lidhen me shkaqe objektive si psh: mungesa e sallave të lira për gjykim, tejzgjatja tej afatit të parashikuar të gjykimeve parardhëse çka ka kondicionuar edhe shtyrjen e gjykimeve pasardhëse, përsëritja disa herë e thirrjes së palëve në rastet kur nuk janë prezent në orarin e caktuar dhe kryerja me vështirësi e veprimeve përgatitore të sallës nga ana e sekretares gjyqësore, problemet teknike me sistemin audio, duke relatuar në çdo rast shkakun e fillimit me vonesë të seancës.”*

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik dhe burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka kryer me efikasitet veprimet procedurale për organizimin dhe zhvillimin e procesit gjyqësor, duke respektuar afatet procedurale për zhvillimin e tyre, si dhe duke marrë të gjitha masat për zhvillimin e gjyqimit në kohë duke respektuar të drejtat e palëve ndërgjyqëse.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE.

2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezultojnë se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës gjatë veprimeve paraprake, nëse ka. Më pas kalohet tek procesverbalet, parashtrimet e palëve etj. gjithmonë sipas datës së zhvillimit të seancës. Në rastin konkret renditja sipas llojit të akteve procedurale por e ndërthurur kjo edhe me veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari gjatë gjykimit, është dhe konsiderohet si një mënyrë që e bën të lehtë dhe të aksesueshme dosjen. Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi. Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezultojnë se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin kronologjik, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtari ka parashtruar se: *“Çmohet se kam aftësi shumë të lartë për të renditur aktet e dosjes gjyqësore, në mënyrë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme. Në të gjitha dosjet gjyqësore është ndjekur i njëjti sistem i renditjes së akteve, duke e bërë dosjen lehtësisht të shfrytëzueshme. Aktet procedurale të gjykatës janë renditur sipas një rendi kronologjik, duke e bërë lehtësisht të verifikueshme procedurën e ndjekur edhe për gjykatën më të lartë që kontrollon bazueshmërinë në ligj dhe në prova të vendimit të gjykatës”.*

KONKLuzioni

Në tërësi, rezultojnë se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*kërkesa e prokurorit apo e të dënuarit, provat dhe diskutimet përfundimtare të palëve*).

Në dosjet penale nuk rezulton të jetë administruara kopje e “Letres së të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a¹⁶⁷, 58¹⁶⁸, 140¹⁶⁹ paragrafi 1 dhe 137¹⁷⁰ i K.Pr.Penale. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34/a dhe 58 të K.Pr.Penale subjekteve i janë garantuar, duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mosadministrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë. Gjyqtari ka parashtruar se: “Çmuj se gëzoj aftësi shumë të lartë për të garantuar që dosja mos të ketë mungesa aktesh dhe që dokumentacioni i përfshirë në dosje të jetë i duhuri

¹⁶⁷ Në nenin 34/a. pika 2 dhe 3 te K.Pr.Penale parashikohet se: “2. Përpara marrjes në pyetje për herë të parë ose përpara kryerjes së akteve ku prania e tij është e detyrueshme, sipas ligjit, organi procedues e njofton të pandehurin për të drejtat e parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe “e”, të pikës 1, të këtij neni, duke i dhënë, kundrejt nënshkrimit, letrën e të drejtave në formë të shkruar.

3. Të drejtat dhe garancitë e parashikuara për të pandehurin zbatohen edhe për personin nën hetim dhe personin, të cilit i atribuohet vepra penale, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parashikon ndryshe.”.

¹⁶⁸ Neni 58 pika 2 i K.Pr.Penale parashikon se ; » 2. Organi procedues njofton menjëherë viktimën për të drejtat e përmendura në paragrafin 1, të këtij neni, dhe mban procesverbal për njoftimin e tyre. »

¹⁶⁹ Neni 140 paragrafi 1 parashikon se;”1. Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë bëhet duke i dorëzuar atij personalisht kopjen e aktit së bashku me letrën e të drejtave, sipas nenit 34/a, të këtij Kodi. Kur nuk mund t’i dorëzohet personalisht, njoftimi bëhet në banesën e tij ose në vendin e punës, duke ia dorëzuar aktin një personi që bashkëjeton me të ose një fqinji, ose një personi që punon me të. Në aktin e njoftimit tregohen gjenealitetet e personit që merr përsipër njoftimin dhe lidhja e tij me të pandehurin.”

¹⁷⁰ Neni 137 paragrafi i 1 parashikon se: “1. Njoftimet për personin e dëmtuar nga vepra penale bëhen njëjloj si për rastet kur njoftohet për herë të parë i pandehuri i lirë.”

dhe t'i përkasë çështjes konkrete. Në dosjet gjyqësore, përfshihen të gjitha aktet dhe provat e paraqitura nga palët të cilat janë administruar në seancë gjyqësore. Gjithashtu, dokumentacioni i administruar në dosje, është dokumentacioni që i përket çështjes gjyqësore konkrete. Asnjëherë nuk është evidentuar ngatërresë në lidhje me përfshirjen në fashikull të akteve që u përkasin dosjeve të tjera apo pretendime për humbje të dokumentacionit të administruar..”.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari paraqiti kundërshtime dhe kërkoi pikëzim maksimal duke pretenduar se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër është mbajtur një praktikë pas ndryshimit të Kodit të Procedurës Penale, që të pandehurve në gjendje të lirë ose viktimave t'i njoftohej bashke me letërthirrjen edhe një kopje e “Letrës së të drejtave”, për këto arsye kjo e fundit nuk kthehej rregullisht mbrapsht me firmën e subjektit si letërthirrja por mbahej nga i pandehuri. Por në çdo rast gjykata i pyeste panlët nëse ishin njohur me kartën e të drejtave dhe kujdesej për garantimin e saj. Gjithashtu, gjykata kujdesej edhe në drejtim të garantimit të të drejtave të pandehurve dhe personave nënhetim, duke verifikuar dorëzimin e “Letrave të të drejtave” që në fazën e hetimeve paraprake. Në kundërshtimet e tij gjyqtari ka relatuar disa dosje gjyqësore ku rezultonte të ishte administruar letra e të drejtave si dhe disa dosje kur nuk ishte administruar porse këto të fundit janë regjistruar në gjykatë përpara ndryshimeve të Kodit të Procedurës Penale apo në ato raste kur nuk kishte subjekte procedurale si, persona nën hetim, viktimat apo të pandehur që mund t'i njoftohej letra e të drejtave. Gjithashtu ka relatuar edhe disa dosje gjyqësore, tek të cilat nuk gjendej i administruar “Letra e të Drejtave”.

Këshilli pasi u njoh me të gjitha burimet e vlerësimit, dosjet gjyqësore si dhe raportin analitik të hartuar nga nënpunësia përgjegjëse konstatohet se letra e të drejtave nuk ishte administruar në një pjesë të mirë të dosjeve gjyqësore. Nga ana e vlerësuesit në vlerësimin e këtij treguesi janë përjashtuar normalisht dosjet që i përkasin periudhës së vlerësimit përpara hyrjes në fuqi ligjit nr. 35/2017, datë 30.3.2017, që ndryshojë disa dispozita të Kodit të Procedurës Penale që parashikojnë këtë detyrim të gjykatës, ligji i cili ka hyrë në fuqi në muajin gusht të vitit 2017. Gjithashtu, nuk janë vlerësuar se paraqesin mangësi në këtë aspekt dosjet të cilët nuk janë identifikuar subjektet procedurale si persona nën hetim, i pandehuri apo nuk janë identifikuar dhe nuk mund të identifikohen viktimat.

Gjyqtari pretendoi se çështja penale që i përket vendimit nr.192-5201, datë 11.12.2027 nuk ka administruar letrën e të drejtave pasi kjo çështje është gjykuar me procedurën e vjetër penale. Në fakt, nga burimet e vlerësimit, konkretisht kopje e vendimit gjyqësor si dhe e dosjes gjyqësore, konstatohet se kjo çështje është regjistruar në datë 27.09.2021, pra pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.35/2017 e për këtë arsye për gjykimin e saj do të zbatoheshin dispozitat e reja të K.Pr.Penale.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë mbi mesataren për

këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të "Letrës të të drejtave" e cila nuk rezulton të jetë administruar në të gjitha dosjet gjyqësore ku ka qenë e nevojshme njoftimi i saj, bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është "Mbi mesatare" dhe pikëzohet me 8 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI AFTËSITË ORGANIZATIVE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
98	Shkëlqyeshëm

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A ETIKA NË PUNË

3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me të dhënat që mund të tregojnë cenimin e etikës apo përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit u konstatuan këto të dhëna:

Referuar informacionit të përcjellë prej Inspektorit të Lartë të Drejtësisë¹⁷¹ dhe gjyqtarit subjekt vlerësimi¹⁷², rezulton se ndaj gjyqtarit {...} në periudhën e vlerësimit 2017-2019

¹⁷¹ Shkresa nr. 2713/1 prot., datë 21.10.2022

se janë depozituar dy ankesa dhe një informacion:

- Ankesë e ankuesit Gëzim Hasa, ankesë e regjistruar pranë zyrës së ILD me nr. 261 prot., datë 28.01.2021. Përmes kësaj ankesë, ankuesi ngre pretendime në lidhje me vendimin nr. 857 (2745) datë 27.06.2017 të gjyqtarit subjekt vlerësimi, vendim në të cilin ankuesi rezulton në cilësinë e paditësit. Në themel të ankesës së tij, ankuesi pretendon për zvarritje të gjykimit dhe vonesë në arsyetimin e vendimit. Pas verifikimit të kryer, është konstatuar se ka kaluar afati i parashkrimit, e për rrjedhojë duke vlerësuar mospërbushjen e kriterit të pranueshmërisë referuar nenit 117 të ligjit nr. 96/2016, me vendimin nr. 211/1 prot., datë 20.04.2023, Inspektori i Lartë i Drejtësië ka disponuar *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga shtetasi z. Gëzim Hasa.”*
- Ankesë e ankuesit Rita Qerimaj, ankesë e depozituar pranë Ministrisë së Drejtësisë, e cila më pas i është përcjellë për kompetencë trajtimi ish-KLD-së, regjistruar me nr. 3034 prot., datë 29.09.2014. Në vijim, kjo praktikë i është përcjellë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e cila është regjistruar me nr. 265 prot., datë 28.01.2021. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë vendimin nr. 265/2 prot., datë 11.06.2021 *“Për arkivimin pas verifikimit të ankesës së paraqitur nga znj. Rita Qerimaj.”*

Duhet theksuar se praktika e ankueses znj. Rita Qerimaj mban datën 29.09.2014, e rrjedhimisht nuk është objekti i vlerësimit të gjyqtarit për periudhën e vlerësimit 1 janar 2017- 31 dhjetor 2019.

Sikurse rezulton nga shkresat e mësipërme, ankesa ndaj gjyqtarit është arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të çënojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e etikës së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B INTEGRITETI I GJYQTARIT

3.B.a Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjtëti.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, për periudhën 01.01.2017 - 31.12.2019, rezulton se për gjyqtarin {...} është depozituar dy ankesa dhe një informacion të cilat janë arkivuar.

Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezulton se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Referuar raportit të ILDKPKI, përcjellë pranë KLGJ me shkresën nr. 3349/2 prot. datë 18.11.2022, rezulton se: a) *Deklaratat e interesave private periodike/vjetore 2017-2020 janë dorëzuar brenda afateve ligjore; b) Gjatë kontrollit u konstatua se deklaratat e interesave private janë plotësuar në përputhje me kërkesat e ligjit; c) Nga kontrolli i ushtruar nuk u verifikuan raste të konfliktit të interesave.*

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë apo indicie që të dëshmojë për ekzistencën e shfaqjeve të pahijshme, cenim të nderit dhe dinjtetit të gjyqtarit, shfaqjen e sjelljeve që tregojnë favor ose disfavor në lidhje me çështjet në gjykim, apo çdo sjellje tjetër që mund të cenojë integritetin e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjtetin e gjyqtarit.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e integritetit të gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

3.C.a Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit pasqyruar në Raportin Analitik, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor, akteve të administruara në dosjet e gjykimit, si dhe të dhënave nga vetëvlerësimi i gjyqtarit.

Gjyqtari lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se për periudhën e vlerësimit 01.01.2017–31.12.2019, janë paraqitur 7 kërkesa për përjashtimin e subjektit të vlerësimit, të cilat janë rrëzuar të gjitha. Ndërkohë, rezulton se vetë subjekti i vlerësimit nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për heqje dorë.

Gjyqtari e ka vlerësuar numrin e kërkesave të pranuar për përjashtim si të pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Sa më sipër, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “*I pakonsiderueshëm*”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, nuk është pranuar asnjë kërkesë nga 7 kërkesat për përjashtimin e tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit”, vlerësohet se ky numër është “I pakonsiderueshëm” dhe pikëzohet me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit KRITERI ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Pikët	Niveli i vlerësimit
100	Shkëlqyeshëm

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT.

4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë dhe transparent. Gjithashtu evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë dhe drejtpërdrejtë. Në përgjithësi, gjyqtari përdor fjalë të thjeshta dhe të drejtpërdrejta, si dhe ndërton fjali me gjatësi mesatare, të cilat lidhen me njëra tjetrën për nga

vijimësia e mendimit. Konstatohet gjithashtu përdorimi i fjalive të gjata me qëllim mosndërprerjen e logjikës së arsytimit.

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e saj në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast komunikon në mënyrë të qartë dhe transparente me palët dhe pjesëmarrësit në proces, duke treguar kujdes të jetë i qartë, i drejtpërdrejtë dhe i kuptueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.*

4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk konstatohet që gjyqtari të ketë ceduar në ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale në lidhje me informacionet dhe të dhënat për të cilat ai është në dijeni për shkak të funksionit.

I njëjti konstatim rezulton edhe nga aktet e dosjeve të përzgjedhura me short, përfshirë këtu regjistrimet e seancave me mjete audio.

Gjyqtari, lidhur me këtë tregues, e ka vlerësuar aftësinë e tij në nivel të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.*

4.B AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR.

4.B.a Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezultojnë asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Gjithashtu rezultojnë se në ILD është depozituar një ankesë ndaj gjyqtarit e cila është arkivuar. Ndërkohë, sa i takon masave disiplinore, rezultojnë se nuk është depozituar asnjë vendim i tillë prej organeve kompetente dhe për rrjedhojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk disponon informacionin e kërkuar.

Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si dhe shkëmbimi i njohurive dhe përvojës profesionale me ta, është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në lidhje me treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.b Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik nuk rezultojnë të dhëna që negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore, ndërkohë që gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONI

Në tërësi, nga të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezultojnë se shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore është shumë e lartë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T'U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjyqtari {...}, gjatë periudhës së vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e pjesëmarrësit¹⁷³. Konkretisht, rezulton se gjyqtari {...} është angazhuar në aktivitete trajnuese si më poshtë:

- (i) Në cilësinë e pjesëmarrëses në Programin e Formimit Vazhdues në 17 (shtatëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit (nga data 15.03.2017 deri në datë 17.12.2019), gjithsej 31 ditë trajnimi.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Shkolla e Magjistraturës dhe jashtë saj, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës penale, por edhe civile, gjithsej 17 aktivitete të zhvilluara për 31 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në të gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është brenda kufijve 15-120 ditë dhe pikëzohet me 20 pikë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve.

¹⁷³ Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përllogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrjeje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përllogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton se gjyqtari të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimi të angazhimit në këto veprimtari, vlerësohet se për gjyqtarin {...} duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit në aktivitete trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari {...} ka deklaruar se: *“Kam shprehur vullnetin tim për përfshirjen në listën e gjyqtarëve udhëheqës për kandidatët për gjyqtarë. Pavarësisht disponimit tim të shprehur, nuk është caktuar asnjë Magjistrat për të kryer stazhin profesional në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër.”*

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk është angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësues apo ekspert pranë Shkollës së Magjistraturës, si dhe nuk rezulton të ketë udhëhequr kandidatën për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

***Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësohet se në lidhje me treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit dhe për pasojë pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtaritë për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, nuk rezulton të ketë të dhëna për këtë tregues.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari {...} ka deklaruar se: *“Përsa i përket angazhimit tim jashtë funksionit, kam shprehur bashkëpunimin tim gjithmonë në lidhje me nevojën e përmirësimit të programit të formimit fillestar dhe vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjithmonë, i jam përgjigjur thirrjes së Këshillit Drejtues së Shkollës së*

Magjistratutës, për të propozuar tema të caktuara të cilat duhet të përfshihen në formimin vazhdues së Shkollës së Magjistraturës. Gjithashtu çmuj se përmirësimi i sistemit të drejtësisë realizohet më së miri duke kryer detyrën me korektësi dhe përkushtim, duke respektuar parimet themelore dhe përmbushur detyrimet procedurale, objekt të cilin mendoj se e kam arritur..”

Formularit të integruar të vlerësimit, gjyqtari i ka bashkëlidhur shkresën me numër extra protokolli, datë 01.10.2023 të Dhomës së Avokatisë Shkodër me lëndë “Vërtetim”, prej së cilës rezulton se ai ka zhvilluar diskutime të hapura me avokatët mbi bazën e kërkesës së Dhomës së Avokatisë Shkodër për tema në fushën e së drejtës civile dhe penale.

Bazuar në vërtetin e sipërpërmendur, rezulton se në datat 18.05.2017 dhe 20.11.2019, si përgjigje e kërkesës së një grupi avokatësh civilistë dhe penalistë të Dhomës së Avokatisë Shkodër, gjyqtari {...} ka zhvilluar dy diskutime të hapura me avokatët përkatësisht me temat “Pavlefshmëria e faturave tatimore të shitjes së energjisë elektrike me cilësinë e titullit ekzekutiv dhe problematikat e saj në praktikën gjyqësore” dhe për çështjet administrative që lidhen me kërkesat e të dënuarve pranë IEVP-së Reç për të përfituar ulje dënimi për periudhat e prapambetura të vuajtjes së dënimit të pakërkuara ndërvite.

Lidhur me këtë tregues në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se;”Gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si: fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshëm me qëllim rritjen e cilësisë së gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike”.

Në lidhje me këtë vërtetim të paraqitur nga gjyqtari së bashku me Formularin e integruar të vlerësimit, nga ana e relatores u vlerësua se ai tregon pjesëmarrjen e tij në dy takime të zhvilluar nga Dhoma Vendore e Avokatisë, me kërkesë të tyre, me qëllim diskutimin e praktikave të reja që ky gjyqtar kishte krijuar në gjykatën e rrethit gjyqësor Shkodër lidhur me pavlefshmërinë e titujve ekzekutiv, faturave tatimore të shitjes së energjisë elektrike si dhe të praktikës lidhur me shqyrtimin e kërkesave të dënuarve për të përfituar ulje dënimi për periudhat e prapambetura dhe nuk përbëjnë angazhim në veprimtari ndërinstitucionale siç përcaktohet në Rregulloren¹⁷⁴ e miratuar nga Këshilli mbi Metodologjinë e Pikëzimit.

Lidhur me këtë tregues, gjyqtari paraqiti kundërshtimet dhe kërkoi pikëzim maksimal duke pretenduar se ai në bazë të kërkesës së Dhomës së Avokatisë Shkodër ka marrë pjesë në dy diskutime të hapura me kohëzgjatje 60 minuta me temat e lartpërmendura, i cili ka qenë

¹⁷⁴ Miratuar me vendimin nr.264, datë 21.11.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

trajtimi i aspekteve të përgjithshme, duke evidentuar materialet teorike dhe literaturën përkatëse si dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, për aq sa ka qenë e mundur, pa u ndalur në asnjë rast në trajtim dhe analizimin e çështjeve të veçanta, si dhe sugjerimin apo mendimin mbi zgjidhjen e ndonjë çështje civile dhe penale konkrete. Për këtë arsye, duke qenë se mbrojtësit janë subjekte të rëndësishme në procesin gjyqësor penal e civil vlerëson se ka dhënë kontributin e tij në rritjen e efektivitetit të gjyqësorit dhe dhënies së drejtësisë, pasi të kuptuarit dhe zbatimit korrekt dhe i njëzuar i ligjit e në përputhje me qëllimin e tij nga të gjithë aktorët e gjyqësorit i shërben vetëm përmirësimit të sistemit të drejtësisë. Gjithashtu, ai pretendoi se gjatë detyrës së tij së gjyqtarit në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër pranë tij kanë ushtruar praktikën mësimorë disa studentë të Universitetit Luigj Gurakuqi, të cilët kanë pasur angazhimin e tij maksimam në funksion të përvetësimit të njohurive juridike. Për të provuar këtë fakt, ai paraqiti disa vërtetime dhe shkresa të cilat provojnë se pranë gjyqtarit kanë ushtruar praktikën profesionale një sërë studentësh.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, gjyqtari mund të dedikojë kohë dhe përpjekje për të përmirësuar sistemin gjyqësor në mënyra të ndryshme. Këto përfshijnë veprimtari jashtë funksionit, me ose pa pagesë, të tilla si (listë joshteruese): fjalime publike; prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efikasitetit; kontribute në hartimin e legjislativacionit; aktivitete mësimdhënëse për çështje ligjore; bashkëpunimi me grupe interesash të ndryshme me qëllim rritjen e cilësisë të gjyqësorit dhe ndërgjegjësimin e publikut për forcën e zbatimit të ligjit, si edhe çdo veprimtari tjetër e ngjashme në fushën juridike.

Në të gjitha format e shfaqjes së veprimtarisë ndërinstitucionale, duhet të provohet kontributi dhe angazhimi efektiv i gjyqtarit për përmirësimin e sistemit të drejtësisë.

Referuar burimeve të vlerësimit sa i përket angazhimit të gjyqtarit në dy takimet e zhvilluara nga Dhoma e Avokatisë Shkodër, Këshilli vlerësoi se ky angazhim nuk mund të konsiderohet veprimtari ndërinstitucionale, për përmirësimin e sistemit të drejtësisë, pasi nga përmbajtja e vërtetimit konstatohet se gjyqtari është ftuar në këto takime për të diskutuar praktikën e re të sjellë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, të mbajtur nga vetë gjyqtari {...}, angazhim për të cilin ndër të tjera gjyqtari nuk ka njoftuar Këshillin në përputhje me detyrimin e parashikuar në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ndërsa për sa i përket kryerjes së praktikës mësimore të disa studentëve të drejtësisë pranë gjyqtarit, Këshilli vlerësoi se kryerja e praktikës profesionale të studentëve në Gjykata, ka të bëjë me pjesëmarrjen e tyre në seanca gjyqësore, të cilat janë publik, dhe kryhen pranë çdo gjykate sipas një plani mësimor. Kryerja e praktikës mësimore të studentëve në gjykatë, nuk kërkon asnjë kontribut efektiv të gjyqtarit në kryerjen e kësaj praktike dhe as nuk provohet angazhimi efektiv i tij në drejtimin e praktikës mësimore apo në kryerjen e një veprimtarie mësimore apo vlerësimit nga ana e tij.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, Këshilli vlerësoi se për gjyqtarin {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna për angazhimin e tij.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në veprimtari ndër institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.ç Publikimet ligjore akademike.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë publikuar punime akademike.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari {...}, në lidhje me këtë tregues nuk ka dhënë shpjegime.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtari nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duhet të pikëzohet me 0 pikë.

***Publikimet ligjore akademike dhe pikëzimi:** Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, për treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezultojnë publikime të gjyqtarit dhe për këtë arsye gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit
KRITERI

AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Pikët	Niveli i vlerësimit
91	Shkëlqyeshëm

F- NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	95	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	384	Shkëlqyeshëm

REKOMANDIME

Bazuar në nenin 93, pika 5, shkronja “ç”, të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke iu referuar të dhënave të analizuarra dhe vlerësuara në raport me kriteret e vlerësimit, rekomandohet që gjyqtari {...} t’i kushtojë më shumë të interpretimit individual të ligjit, të mbajë në konsideratë angazhimin e tij në aktivitete për trajnimin e gjyqtarëve, pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale, si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit në këto fusha.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 1 JANAR 2017 - 31 DHJETOR 2019

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				95	Shkëlqyeshëm
Treguesit		Burimet	Shkalla e aftësisë	Pikët	Të dhëna për metodologjinë
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Mbi mesataren	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	1.Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	15	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë

		3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim			Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	1. Dokumentet ligjore të dorëzuara nga gjyqtari 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Aktet e dosjeve të përzgjedhura për vlerësim	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				98	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimet	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në	a. Respektimi i afateve ligjore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 3 pikë 31-40 % - 6 pikë

punë		kryetarit			21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 %- 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë 11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	1. Të dhënat statistikore 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të	1. Të dhënat statistikore	+99%	10	Tej standardit :

	çështjeve gjyqësore	2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit			Nën 81%- 2 pikë Mbi 81-87% - 4 pikë Mbi 87- 93% - 6 pikë Mbi 93-99% - 8 pikë +99% - 10 pikë
	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë

B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	1. Të dhënat statistikore/aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë

	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	1. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short 2. Vetëvlerësimi i gjyqtarit	Mbi mesataren	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 4. Mendimi përfundimtar i kryetarit	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë
B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	1. Informacioni i marrë nga ILD 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Mendimi përfundimtar i kryetarit 4. Të dhënat e raportit të ILDKPKI	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë

C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuuese	1.Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 2.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	1.Të dhënat statistikore 2.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 3.Mendimi përfundimtar i kryetarit	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Pikët total	Niveli i vlerësimit
				91	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit	Pikët	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	1.Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2.Mendimi përfundimtar i kryetarit 3.Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4.Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim 4. Aktet e dosjeve të përzgjedhura me short	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Të dhënat për verifikimin e ankesave	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	1. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës 2. Dosja personale e gjyqtarit 3. Dokumente të dorëzuara nga gjyqtari	5-40 ditë (Periudha 1/vjeçare)	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4

	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Informacioni i marrë nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	c. Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	1. Vetëvlerësimi i gjyqtarit 2. Mendimi përfundimtar i kryetarit 3. Dosja personale e gjyqtarit 4. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të gjyqtarit	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimet ligjore akademike	1. Dosja personale e gjyqtarit 2. Çdo e dhënë tjetër që tregon ngritjen profesionale të saj	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		384			
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		Shkëlqyeshëm			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

